

M

A

R

K

S

PUNA

ME MËDITJE

DHE KAPITALI

R I L I N D J A

Karl Marks

PUNA ME MËDITJE DHE KAPITALI

BOTIMI I KATËRT

RILINDJA

Redaksia e botimeve

Prishtinë 1985

P Ë R M B A J T J A

HYRJE E F. ENGELSIT	4
PUNA ME MËDITJE DHE KAPITALI	18
I	18
II.....	25
III	34
IV	41
V.....	49

HYRJE E F. ENGELISIT

Kjo vepër u botua për herë të parë në formën e kryeartikujve në disa numra të “Gazetës së Re Renane”¹ duke filluar nga 4 prilli 1849. Si bazë e saj janë marrë leksionet, që Marksi lexoi më 1847 në Bashkimin e Brukselit të punëtorëve gjermanë. Botimi i saj u ndërpre; premtimi „Vazhdimi vijon”, që jepej në fund të artikullit në Nr. 269, nuk u plotësua për shkak të ngjarjeve, që shpërthyen në atë kohë — hyrja e rusëve në Hungari, kryengritjet në Drezden, Elberfeld, Pfalz dhe Baden — dhe të cilat shkaktuan ndalimin e vetë gazetës (19 maj 1849). Në dorëshkrimet, që la Marksi, vazhdimi i kësaj vepre nuk ishte.

Si broshurë e veçantë, „Puna me mëditje dhe kapitali” është botuar disa herë dhe për herë të fundit u botua më 1884 në Hettingen-Zyrih, „Shtypshkonja kooperaiviste zvicerane”. Në të gjitha botimet, që kanë dalë deri më sot, është riprodhuar me saktësi teksti i origjinalit. Por me qenë se ky botim i ri është një broshurë me karakter propagandistik dhe duhet të përhapet në një sasi jo më pak se 10 000 kopje, para meje doli pyetja: në këto kushe vetë Marksi a do të pranonte një rishtypje të tekstit pa bërë asnjë ndryshim.

¹ “Neue Rheinische Zeitung” – botohej në Köln prej 1 qershorit 1848 deri më 19 maj 1849. Kryeredaktori i saj ishte Marksi *Red.*

Në vjetët 1840—1850 Marksi nuk e kishte përfun duar akoma kritikën e tij të ekonomisë politike. Këtë ai e bëri vetëm nga fundi i dhjetëvjeçarit 1850—1860. Prandaj shkrimet e tija, që janë botuar para së të dilte fashikulli i parë: „Rreth kritikës së ekonomisë politike" (1859), në disa pika nuk përputhen me shkrimet, që u shkruan pas vitit 1859 dhe përmbajnë shprehje dhe periudha të tëra, të cilat nga pikëpamja e shkrimeve të mëvonshme janë të pagoditura dhe bile jo të drejta. Kuptohet vetvetiu, se në botimet e zakonshme, që caktohen për një rreth të ngushtë publiku, duhet të pëmbahet edhe kjo pikëpamje e hershme e autorit e cila përbën një nga shkallët e zhvillimit të tij, dhe se edhe autori edhe publiku kanë pa dyshim të drejtën e rishtypjes së këtyre veprave të pa bërë asnjë ndryshim. Në rastin e një botimi të tillë mua nuk do të më shkonte as ndër mend që në këto vepra të ndryshoja qoftë edhe një fjalë.

Por puna qëndron ndryshe, kur kemi të bëjmë me botimin e ri, që caktohet pothuajse vetëm për propagandën midis punëtorëve. Në këtë rast Marksi do ta kishte përputhur patjetër shtjellimin e vjetër të vitit 1849 me pikëpamjen e tij të re. Dhe unë jam i sigurtë, se, duke bërë në këtë botm disa ndryshime dhe plotësime, që janë domosdoshme për të arrihur këtë përputhje në të gjitha pikat esenciale, veproj plotësisht sipas dëshirës së tij. Pra, unë e paralajmëroj lexusin, se: kjo broshurë nuk paraqitet ashtu siç e kishte shkruar Marksi më 1849, por afërsisht ashtu siç do ta kishte shkruar ai më 1891.

Nga ana tjetër, teksti origjinal është përhapur në një sasi kaq të madhe kopjesh, sa që do të mjaftojnë deri sa unë të kem mundësi ta ribotoj atë pa ndryshime në një botim të veprave të plota.

Të gjitha ndryshimet, që unë kam bërë, i përkasin vetëm një pike. Sipas origjinalit, punëtori, për pagën, i shet kapitalistit punën e tij; sipas tekstit të tanishëm ai i shet fuqinë punëtore të tij. Në lidhje me këtë ndryshim unë duhet të jap një shpjegim. — Një shpjegim për punëtorët, që ata të shohin, se këtu nuk është puna për një lojë fjalësh, por, përkundrazi, për një nga pikat më të rëndësishme të të gjithë ekonomisë politike. Një shpjegim për borgjezët, që ata të binden për epërsinë e madhe të punëtorëve të pamësuar, të cilët mund të kuptojnë lehtë çështjet ekonomike më të vështira, kundrejt njerëzve tanë mendjemëdhenj „të mësuar“, për të cilët këto çështje të ngatërruara mbeten të pazgjidhura tërë jetën.

Ekonomia politike klasike² mori nga praktika industriale idenë e zakonshme të fabrikantit, gjoja ai blen dhe paguan punën e punëtorëve të tij. Për punët e përditshme të tregtisë, për kontabilitetin dhe për të llogaritur çmimet, për fabrikantin kjo ide ishte plotësisht e mjaftueshme. Por

² me ekonominë politike klasike, shkruan Marksi — unë kuptoj gjithë ekonominë politike duke filluar nga IV. Petti, që analizon lidhjet e brendshme të marrëdhënieve kapitaliste të prodhimit" (K. Marks e F. Engels. Veprat, vëll. XVII, f. 91). Përfaqësuesit më të mëdhenj të ekonomisë politike klasike në kanë qenë. A. Smithi dhe D. Rikardo. *Red.*

kur u kalua në mënyrë naive në ekonominë politike, këtu ajo shkaktoi gabime dhe ngatërresa të çuditshme.

Ekonomia politike gjendet përpara faktit, se çmimet e të gjitha mallrave, midis tyre edhe çmimi i mallit, që ajo e quan punë, ndryshojnë pa rreshtur; ato ngrihen dhe ulen nën ndikimin e rrethanave shumë të ndryshme, të cilat shpesh herë nuk kanë asnjë lidhje me prodhimin e vetë mallit, dhe kështu duket sikur çmimet në përgjithësi përcaktohen vetëm nga gjëra të rastit. Kur ekonomia politike doli si shkencë³, një nga detyrat e para të saj ka qenë të gjente ligjin, që fshihet prapa këtyre gjërave të rastit, të cilat duket sikur sundojnë çmimet e mallrave, ligjin, që në të vërtetë ai vetë sundon mbi këto gjëra të rastit. Në ndryshimet e parreshtura të çmimeve të mallrave dhe në lëkundjet e tyre herë lart, herë poshtë, shkenca kërkonte qendrën e qëndrueshme, rreth së cilës bëhen këto ndryshime dhe lëkundje. Me një fjalë, ajo nisej nga çmimet e mallrave për të gjetur, si një ligj, që i rregullon ato, vlerën e mallrave, me të cilën mund të shpjegohen të gjitha lëkundjet e çmimeve dhe me të cilën, në fund të fundit, mund të barazohen ato të gjitha.

Ekonomia, politike klasike gjeti, se vlera e mallit përcaktohet nga puna, që përmbahet në 'të dhe që është e domosdoshme për prodhimin e tij. Me këtë shpjegim ajo

³ Ekonomia politike, në kuptimin më të ngushtë, ndonëse në kokën e disa njerëzve gjenialë ka lindur nga fundi i shekullit megjithatë në formën e saj pozitive, që i dhanë fiziokratët dhe Adam Smithi, në thelb ajo është bija e shekullit XVIII . (1948, f. 141.) Red.

u kënaq. Dorë për dorë edhe ne mund të ndalemi me kaq. Dho vetëm për të zhdukur keqkuptimet unë e quaj të nevojshme të përmend, se sot ky shpjegim është krejtësisht i pamjaftueshëm. Marksi që i pari, që studioi me themel vetinë e punës për të krijuar vlerë dhe gjeti, se çdo punë, që duket e domosdoshme ose është me të vërtetë e domosdoshme për prodhimin e mallit, nuk i jep këtij në të gjitha rrethanat vlerë me një madhësi të tillë, që t'i përgjigjet sasisë së punës së harxhuar. Prandaj, kur ne sot, bashkë me ekonomistë të tillë si Rikardo, themi shkurt, se vlera e mallit përcaktohet nga puna e domosdoshme për prodhimin e tij, nënkuptojmë gjithnjë rezervat, që bën Marksi. Këtu tani kjo mjafton: të tjerat njeriu mund të gjejë te Marksi, në veprën „rreth kritikës së ekonomisë politike” të vitit 1859 dhe në vëllimin e parë të „Kapitalit”.

Por sapo ekonomistët e përdorën këtë mënyrë caktimi të vlerës me anën e punës për mallin „punë”, ata u ngatërruan në një varg kontradiktash. Nga se përcaktohet vlera e „punës”? Nga puna e domosdoshme, që përmbahet në të. Por sa punë përmban puna, që bën punëtori në një ditë, në një javë, në një muaj, në një vit? Ajo përmban punën e një dite, e një jave, e një muaji, e një viti. Në qoftë se puna është masa e të gjitha vlerave, atëherë „vlerën e punës mund ta shprehim vetëm me punë. Por ne nuk dimë absolutisht asgjë mbi vlerën e një orë pune, dhe dimë vetëm, ajo është barazi me një orë punë. Në këtë mënyrë ne nuk i afrohem qëllimit tonë as një qime, por vazhdojmë të vimë rrotull gjithnjë në një rreth pa krye.

Atëherë ekonomia politike klasike u orvat të gjejë një rrugëdalje tjetër. Ajo tha: vlera e mallit është barazi me shpenzimet e tij të prodhimit. Por ç'janë shpenzimet e prodhimit të punës? Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje ekonomistët duhej të dhunonin pak llogjikën. Në vend të shpenzimeve të prodhimit të vetë punës, që për fat të keq nuk mund të caktohen, ata studjojnë se cilat janë shpenzimet e prodhimit të punëtorit. Dhe këto shpenzime mund të caktohen. Ato ndryshojnë sipas kohës dhe rrethanave por për një gjendje të caktuar të shoqërisë, për një vend të caktuar, për një degë të caktuar të prodhimit, ato janë gjithashtu një madhësi e caktuar të paktën brenda disa kufijve mjaft të ngushtë. Tani ne jetojmë në kushtet, kur sundon prodhimi kapitalist, në të cilin një klasë e madhe e popullsisë dhe që rritet gjithënjë mund të jetojë vetëm në qoftë se punon me pagë për zotëruesin e mjeteve të prodhimit — veglave, maqinave, lëndwv së parë dhe mjeteve të jetesës. Në këtë mënyrë, prodhimi, shpenzimet e prodhimit të punëtorit janë barazi me shumën e mjeteve të jetesës, ose me çmimin e tyre në para, — që janë të domosdoshme për ta bërë atë të aftë punë, për të ruajtur aftësinë e tij për punë për ta zëvendësuar atë me një punëtor tjetër, kur ai del nga binarët për shkak të pleqërisë, të sëmundjes ose të vdekjes, d.m.th me shumën e mjeteve të jetesës të nevojshme për t'i dhënë mundësi klasës pshunëtore që të shtohet në masën e duhur. Ta zëmë, se çmimi në para i këtyre mjeteve të jetesës, mesatarisht, është 3 marka në ditë.

Pra, punëtori ynë merr nga kapitalisti, që e ka pajtuar, një pagë prej 3 markash në ditë. Për këtë pagë kapitalisti e detyron atë të punojë, ta zëmë, 12 orë në ditë. Dhe kapitalisti bën pak a shumë këtë llogari:

Ta zëmë, se ky punëtor, i cili është mekanik, duhet të bëjë një vegël maqine, dhe se e mbaron në një ditë. Ta zëmë, se lënda e parë — hekuri dhe tunxhi, të cilët kanë formën e duhur dhe janë përpunuar më parë — kushton 20 marka.

Ta zëmë se qymyrguri i konsumuar për maqinën me avull dhe konsumin e vetë maqinës, i tornos dhe i veglave tjera, me të cilat punon punëtori, të llogaritura për një ditë dhe për një punëtor janë barabartë me vlerën e një 1 marke. Ta zëmë se paga e një ditë është 3 marka. Këto për këtë vegël maqine bëjnë gjithsej 24 marka. Por kapitalisti shpreson, se nga blesit e tij do të marri mesatarisht një çmim prej 27 mar kash, dmth. 3 marka më tepër, se shpëzimet e ba me prej tij.

Nga dalin këto 3 marka, që i merr kapitalisti? Simbas ekonomis politike klasike, mallnat shiten mesatarisht simbas vleftave të tyre, dmth. me çmimet, që u përgjigjen sasive të domosdoshme të punës, që përmbajnë këto mallna. Pra, çmimi mesatar i veglës sonë të maqinës — 27 marka është barazi me vleftën e saj, dmth. barazi me sasin e punës, që ajo përmban. Por nga këto 27 marka, 21 marka kanë qenë tashmë vleftë e gatshme para se të fillonte me punue mekaniku ynë, 20 marka gjinden në landën e parë, 1 markë në qymyrgurin e djegun në kohën e punës ose në maqinat dhe veglat, që u përdorën, aftsjaja

prodhuese e të cilave u paksue në përputhje me këtë përdorim. Mbeten 6 marka, që iu shtuen vleftës së landës së parë. Por këto 6 marka, si e marrin me mend edhe ekonomistët tanë, mund të dali vetëm nga puna, që i ka shtue puntori ynë landës së parë. Puna e tij prej 12 orësh ka krijue, kështu, një vleftë të re prej 6 markash. Pra, vlefta e punës së tij prej 12 orësh është barazi me 6 marka. Dhe kështu, më në fund, kishim me zbulue se ç'është „vlefta e punës”.

„Ndalu!” thërret mekaniku ynë. „Gjashtë marka? Po unë kam marrë vetëm tri! Kapitalisti im ban be në çkado se vlefta e punës sime prej 12 orësh është vetëm me tri marka, dhe poqese unë i kërkoj gjashtë, ai do të tallet me mue. Si spjegohet kjo?”

Nëqoftëse më parë me vleftën tonë të punës kishim ra në një rreth të mbyllun pa dalje, tash jemi ngatrrue krejtsisht në një kontradiktë të pazgjidhshme. Kërkojshim vleftën e punës, ndërsa gjetëm ma shumë se ç'na duhej. Për puntorin vlefta e punës 12 orëshe është 3 marka, ndërsa për kapitalistin është 6 marka, prej të cilave ai 3 ia jep puntorit si pagë, kurse 3 i fut në xhep të vet. Pra puna nuk paska një vleftë por dy vlefta dhe madje krejt të ndryshme!

Kontradikta bahet edhe ma absurde posa vleftat e shprehuna në të holla i kthejmë në kohë pune. Në 12 orë punë krijohet një vleftë e re prej 6 markash. Pra, në 6 orë krijohet një vleftë e re prej 3 markash, shumë, që merr puntori Për punën 12 or she. Për 12 orë punë puntori merr si ekuivalent pro duktin e 6 orëve punë. Prandej, ose puna

ka dy vlefte, prej të cilave njana asht dy herë ma e madhe se tjetra, ose 12 janë barazi me 6! Në të dyja rastet s'kemi gja tjetër, veçse absurditet.

Sado që të përpiqemi, nga kjo kontradiktë na nuk do të dalim derisa të flasim për blemje dhe shi tje të punës, si dhe për vleftë të punës. Dhe pikërisht kështu ka ndodhë me ekonomistët. Përpyekja e fundit e ekonomis politike klasike, shkolla e Rikar dos, dështoi kryesisht, sepse ajo nuk mundi ta zgjidhte këtë kontradiktë. Ekonomia politike klasike kishte hy në një rrugë pa krye. Ai që gjeti rrugën për të dalë nga kjo rrugë pa krye, qe Karl Marksi.

Ato, që ekonomistët i quejshin shpenzime të prodhimit të „punës“, në të vërtetë nuk janë shpenzime të prodhimit të punës, por shpenzime të vetë puntorit të gjallë. Dhe ajo, që puntori i shiti kapitalistit, nuk ishte puna e tij. „Kur puna e tij fillon me të vërtetë“, thotë Marksi, „ajo nuk i përket ma atij, dhe prandaj ai nuk mund ta shesi atë“. Ai mund të shesi vetëm punën e tij t'ardhshme, dmth, ai mund të zotohet që të kryejë një punë të caktue me në një kohë të caktueme. Por, me këtë ai nuk e shet punën (që nuk asht krye ende), por ven në dispozicion kapitalistit me një pagë të caktueme një kohë të caktueme (kur paga asht me kohë) ose për një punë të caktueme (kur paga asht me copë) fuqin e tij punuese: puntori jep me qera ose shet fuqin punuese të tij. Por kjo fuqi punuese asht shkri në personin e puntorit, dhe e pandame prej tij. Prandaj shpenzimet e prodhimit të saj të barabarta me shpenzimet e prodhimit të puntorit; çka ekonomistët i quejshin shpenzime të prodhimit të punës, këto janë pikërisht

shpenzime të prodhimit të puntorit, dhe si rrjedhim edhe shpenzimet e prodhimit të fuqis punuese. Kështu, pra, nga shpenzimet e prodhimit të fuqis punuese ne mund të kalojmë në vleftën e fuqis punuese dhe të caktojmë sasin e punës së nevojshme shoqnore që duhet për të prodhues fuqin punuese të një cilsije të caktueme, gjâ, që e bani Marksi në kapitullin mbi blemjen dhe shitjen e fuqis punuese („Kapitali" vëllim I, kap. IV, 3).

Por ç'ndodh mandej, mbasi puntori i shet kapitalistit fuqin e tij punuese, dmth. mbasi ai e ka vu atë në dispozicion të kapitalistit për një pagë të caktueme qysh mâ parë — me kohë ose me copë? Kapitalisti e çon puntorin në punishten ose fabrikën e tij, ku gjinden të gjitha sendet e nevojshme për punë: landa e parë, materialet ndihmëse (qymyrguri, ngjyra etj.), vegla, maqina. Këtu puntori fillon të punojë si argat. Ta zamë, se paga e tij ditore âsht, si mâ parë, 3 marka, dhe nuk ka aspak randsi nëqoftëse ai i merr këto për kohë ose për copë. Ta zamë gjithashtu, edhe në këtë rast puntori, me punën e tij 12 orshe, i shton landës së parë të harxhueme një vleftë të re prej 6 markash, të cilën kapitalisti e realizon, kur ai shet produktin e gatshëm. Prej tyne ai i paguen puntorit 3 marka dhe 3 të tjerat i mban për vehte. Por, poqese puntori në 12 orë prodhon një vleftë prej 6 markash, atëherë në 6 orë ai prodhon një vleftë prej 3 markash. Pra, mbasi të ketë punue për kapitalistin 6 orë, puntori i kthen atij kundërvleftën e 3 markave që ka marrë si pagë. Mbas 6 orë punë, ata që të dy janë fit e fit; asnjani nuk i mbetet hua tjetrit asnjë dysh.

„Ndalu!" thërret mandej kapitalisti. „Unë e kam pajtue puntorin për të tanë ditën, për dymbëdhjetë orë; kurse gjashhtë orë janë vetëm një gjysmë dite. Prandaj, përvishju punës derisa të mbarojnë edhe 6 orë tjera, sepse vetëm atëherë do të jemi fit e fit!" Dhe në të vërtetë puntorit i duhet t'i përmbahet kontratës së tij, që e ka lidhë „vullnetarisht", simbas së cilës ai asht zotue, se për produktin e punës, që kushton 6 orë punë, të punojë plot 12 orë.

Të njajtën gjã kemi edhe me pagën për copë. Ta zamë, se puntori ynë në 12 orë prodhon 12 copë të një malli. Për secilën copë të mallit landa e parë dhe amortizimi i maqineris janë barazi me 2 marka, ndërsa çdo copë e mallit shitet 2 1/2 marka. Kapitalisti po në kushte të njejta si ma sipër, do t'i paguejë puntorit 25 pfenig për copë; për 12 copë ai do të paguejë 3 marka, ndërsa puntori, që t'i marrë këto, duhet të punojë 12 orë. Për 12 copë kapitalisti merr 30 marka; po të zbresim 24 marka për landën e parë dhe amortizimin e maqineris, mbetën 6 marka, prej të cilave 3 ai ia paguen si pagë puntorit, kurse 3 i mban për vedi; Gjithçka ndodh sikurse edhe në shembullin e parë. Edhe në këtë rast puntori punon 5 orë për vehte, dmth. për të kompensue pagën e tij (një gjysmë ore për secilën nga të 12 orët), kurse 6 orë për kapitalistin.

Vështirsija, që nuk munden ta kapërxejshin as ekonomistët ma të mirë, derisa ata niseshin nga vlefte e „punës", zhduket porsa në vend të saj ne marrim si pikënisje vleftën e „fuqis punuese". Në shoqnin e sotshme kapitaliste, fuqija punuese asht mall, mall si dhe çdo mall

tjetër, por, megjithate, një mall krejt i veçantë. Puna është se ky mall ka vetin e veçantë që të jetë një forcë, e cila krijon vlefte, të jetë burim vlefte, madje kur përdoret si duhet – të jetë burimi i një vlefte ma të madhe, se ajo, që ka ai vetë. Në gjendjen e sotshme të prodhimit fuqija punuese e njeriut në një ditë jo vetëm që prodhon një vlefte ma të madhe, se atë, që ka ajo vetë dhe se atë, që ajo kushton, por me çdo zbulim të ri shkencor, me çdo shpikje të re teknike, kjo tepriçë e produktit ditë të fuqisë punuese mbi shpenzimet e saj ditore rritet; pra, pjesa e ditës së punës, gjatë së cilës puntori riprodhon vlefte e pagës së tij ditore paksohet, ndërsa, nga ana tjetër, zgjatet pjesa e ditës së punës gjatë së cilës puntori duhet t'i dhurojë kapitalistit punën e tij falas.

Ky është rendi ekonomik i gjithë shoqërisë sonë të sotshme; vetëm klasa puntore është ajo, që prodhon të gjitha vlefte. Sepse vlefte nuk është gjë tjetër, veçse një shprehje tjetër e punës, një shprehje e tillë, me të cilën në shoqërinë tonë të sotshme kapitaliste tregohet sasia e punës së nevojshme shoqërore që përban një mall i caktuar. Por këto vlefte që i prodhojnë puntorët nuk janë të puntorëve. Ato janë të pronarëve, të landës së parë, të makinave, të veglave dhe mjeteve tjera t'investueme, të cilat u lejojnë atyre pronarëve të blejnë fuqinë punuese të klasës puntore. Pra, nga e gjithë sasia e produkteve që ka prodhues klasa puntore, ajo merr vetëm një pjesë. Dhe, si e pamë më sipër, pjesa tjetër, të cilën klasa kapitaliste e mban për vehte ose të cilën ajo duhet ta ndajë jo vetëm me klasën e pronarëve të tokës, rritet mbas çdo zbulimi dhe shpikjeje të re, kurse

pjesa që i mbetet klasës puntore (e Ilogaritun për frymë) ose rritet shumë ngadalë dhe shumë pak, ose nuk rritet fare dhe në disa kushte madje edhe mund të paksohet.

Por këto shpikje dhe zbulime, që po bahen njana mbas tjetrës me një shpejtsi gjithnjë më të madhe, dhe ky rendiment i punës së njeriut, që po rritet nga dita në ditë në përpjestime të pashembullta, krijojnë, në fund të fundit, konfliktin, nga i cili duhet të zhduket ekonomija e sotme kapitaliste. Në njatën anë kemi pasuni pa masë dhe tepriçë produktesh, që blersit nuk janë në gjendje t'i blejnë. N'anën tjetër, kemi shumicën e madhe të shoqnis, që asht proletarizue, që asht shndërrue në puntorë me mëditje dhe që pikërisht për këtë arsye ajo asht në gjendje ta blejë këtë tepriçë produktesh. Ndamja e shoqnis në një klasë të vogël, të pasun pa masë, dhe në një klasë shumë të madhe puntorësh me mëditje, që nuk kanë pronë, ban që kjo shoqni të mbytet në bollëkun e vet, kurse shumica e madhe e antarëve të saj ose mezi i banë ballë, ose nuk i ban dot ballë fare vorfnis pa kufi. Kjo gjendje e shoqnis bahet dita-ditës ma absurde dhe e kotë. Ajo duhet të zhduket, ajo mund të zhduket. Mund të krijohet një rend i ri shoqnor, ku do të zhduken ndryshimet e sotshme klasore dhe ku' — ndoshta mbas një kohe të shkurtë kalimtare, pak të pamjaftueshme, por sidoqoftë shumë të dobishme nga pikëpamja morale në sajë të shfrytëzimit dhe zhvillimit me plan të forcave prodhuese tashma ekzistuese shumë të mëdha të gjithë antarëve të shoqnis, të detyrimit të barabartë për të gjithë që të punojnë, mjetet e jetesës, mjetet për të gëzue jetën, për përfeksionimin dhe

aplikimin e të gjitha aftësive trupore dhe mendore do të jenë në dispozicion të të gjithëve në një masë gjithnjë më të madhe. Dhe që puntorët po bahen gjithnjë më të vendosun për ta fituar me luftë këtë rend të ri shoqëror, kjo do të provohet në të dy anët e oqeanit, nesër, më 1 Maj dhe të djelën më 3 maj⁴.

- *Friedrich Engels*
Londër, 30 Prill, 1881

⁴) Tred-unionet angleze e kremtojnë ditën ndërkombëtare të proletariatit të djelën e parë mbas 1 majit, e cila më 1891 binte më 3 maj.

PUNA ME MËDITJE DHE KAPITALI

I

Nga shumë anë na kanë qortue, se ne nuk kemi spjegue marrëdhënjet ekonomike, që përbajnë bazën materiale të luftave së sotshme të klasave dhe të kombeve. Ne i kemi prekë sistematikisht këto marrëdhënje vetëm atje, kur ato janë paraqitë drejtpërdrejt në konfliktet politike.

Para së gjithash, duhej gjurmue lufta e klasave në zhvillimin e përditshëm të historis dhe të provohej në mënyrë empirike, në bazë të materialit historik ekzistues dhe që pasunohej nga dita në ditë, se nënshtrimi i klasës puntore, që bani Revolucionet e frorit dhe të marsit⁵, ishte njëkohsisht edhe ngadhënjim ndaj kundërshtarëve të saj — republikanëve borgjezë në Francë, klasave borgjeze dhe katundare në gjithë kontinentin e Evropës, të cilat luftojnë kundër absolutizmit feudal; se fitorja e „republikës së ndershme“ në Francë ishte njëkohsisht disfatë e kombeve, që i ishin përgjegj Revolucionit të frorit me lufta heroike për pamvarsi; se, ma në fund, mbas disfatës që pësuen puntorët revolucionarë, Evropa ra përsëri në skllavnin e saj të vjetër të dyfishtë - në skllavnin anglo-ruse. Lufta e qershorit në Paris, ramja e Vjenës, tragjikomedija e nandorit 1848 në Berlin, orvatjet e dëshprueme të Polonis,

⁵ Domethanë revolucionet e 23-24 frorit 1848 në Paris, të 13 marsit në Vjenë dhe të 18 marsit në Berlin. Red.

Italis dhe Hungaris, mbyjtja e Irlandës me anën e uris — këto ishin momentet kryesore të luftës klasore europiane midis borgjezis dhe klasës puntore, dhe me anën e të cilave ne provuem, se çdo kryengritje revolucionare, megjithse mund të duket, se qëllimet e saj janë shumë larg nga lufta e klasës, duhet të dështojë derisa të fitojë klasa puntore revolucionare, dhe se çdo reformë shoqërore do të mbetet një utopi deri sa revolucioni proletar dhe kundërrevolucioni feudal të mos maten me armë në dorë në një luftë botërore. Në paraqitjen tonë, sikurse asht edhe në vetë realitetin. Belgjika dhe Zvicra në panoramën e madhe historike ishin tabllo tragjekomike dhe karikature; njana — shtet model i monarkis borgjeze, tjetra — shtet model i republikës borgjeze, të dyja — shtete që mendojshin, se qëndrojnë si larg luftës së klasave, ashtu edhe larg revolucionit evropian.

Tash që lexuesit tanë kanë parë se si u zhvillue me 1848 lufta e klasave në formë politike shumë të mëdha, është me vend që t'i shohim më afër vetë marrëdhënjet ekonomike, mbi të cilat mbështetet si egzistenca e borgjezis dhe sundimi i saj klasor, ashtu dhe skllavnija e puntorëve,

Në tre kapituj të mëdhej ne do të parashtrojmë:

- 1) raportin midis punës me mëditje dhe kapitalit, skllavnin e puntorit, sundimin e kapitalistit;
- 2) shkatërrimin e pa shmangshëm të klasave të mesme borgjeze dhe t'ashtuqejtunës shtresë të katundaris në sistemin e sotshëm;

3) nënshtrimin tregtar dhe shfrytëzimin e klasave borgjeze të kombeve të ndryshme europiane, që ban mbi to Anglija despot i tregut botnor, Ne do të përpiqemi të bëjmë një paraqitje sa më të thjeshtë dhe popullore, pa kërkuar nga lexuesi as njohjen e koncepteve më elementare të ekonomisë politike. Ne duem që të na kuptojnë puntorët. Për më tepër që në Gjermani mbretërojnë kudo paditunija më e madhe dhe konfuzioni në kuptimin e marrëdhënjëve ekonomike më të thjeshta të gjithë, tue filluar nga mbrojtësit me damkë të rendit ekzistues dhe deri te magjistarët⁶ socialistë dhe gjenitë politike të papranuara, me të cilët Gjermania e caktuar është më e pasur, se sa me sundues.

Pra, le të shohim çashtjen e parë: Ç'është mëditja? Si caktohet ajo?

Po t'i pyesim puntorët: „Sa e keni mëditjen?“ ata do të përgjigjen: „Unë marr nga borgjezi im 1 markë në ditë“, tjetri: „Unë marr 2 marka“ etj. Simbas degëve të ndryshme të punës, ku ata punojnë, ata do të tregojnë shumën të ndryshme të hollash, që marrin nga borgjezi i tyre për kryemjen e një pune të caktuar, — për shembull, për endjen e një kuti pëlhure ose për radhitjen e një flete shtypi. Megjithatë përgjigjet e tyre janë të ndryshme, ata të gjithë pajtohen në një pikë: mëditja (paga) është shumën e të hollave, që kapitalisti paguën për një kohë pune të caktuar ose për kryemjen e një pune të caktuar.

⁶ Karakteristikën e atyre “magjistarëve socialistë” shife në parathënjen e Engelsit në botimin gjermanisht të “Manifestit të partisë komuniste” 1890 – Red.

Pra, duket sikur kapitalisti blen me të holla punën e puntorëve, ndërsa puntorët i shesin atij me të holla punën e vet. Por kjo është vetëm një dukje. Në të vërtetë, ata i shesin kapitalistit me të holla fuqin punuese të tyre. Kapitalisti e blen këtë fuqi punuese për një ditë, një javë, një muaj, etj. Dhe mbasi e blen, ai e përdor atë të detyrue puntorët të punojnë për atë kohë për sa janë marrë vesh. Po me atë shumë të hollash me të cilën kapitalisti blen fuqin e tyre punuese, për shembull, me 2 marka, ai mund të blente 2 funta sheqer ose një sasi të caktuar të një malli tjetër. 2 markat, me të cilat ai bleu 2 funta sheqer, janë çmimi i dy funtave sheqeri. 2 markat, me të cilat ai bleu fuqin punuese për ta përdorë 12 orë, janë çmimi i punës për 12 orë. Pra, fuqija punuese është një mall, njisoj si sheqeri. I pari matet me anën e orëve, kurse i dyti me anën e peshojës.

Mallin e tyre, fuqin punuese puntorët e shkëmbejnë me mallin e kapitalistit, me të hollat dhe ky shkëmbim bëhet në një proporcion të caktuar. Kaq të holla për atë kohë përdorimi të fuqisë punuese. Për 12 orë punë t'endësohet — 2 marka. Por këto 2 marka vallë a nuk përfaqësojnë të gjitha mallnat tjera, që mund të blehen me 2 marka? Pra, në të vërtetë puntori shkëmbeu mallin e tij, fuqin punuese me mallin e ndryshme, dhe në një proporcion të caktuar. Të dhanë puntorit 2 marka, kapitalisti i ka dhanë atij, si shkëmbim për një ditë punë, atë mish, atë rrobë, atë dru, atë dritë etj. Pra, marka shprehin raportin, në të cilin fuqija punuese shkëmbehet me mallin tjetër, shprehin vlerën e shkëmbimit të fuqisë së tij punuese. Vlefë e

shkëmbimit të një malli, e shprehun në të holla, quhet pikërisht çmimi i tij. Pra, paga nuk është gjë tjetër, veçse një emën i veçantë i çmimit të fuqisë punuese, që zakonisht quhet çmim pune, një emën i veçantë për çmimin e këtij malli të veçantë, i cili nuk mund të ekzistojë ndryshe, veçse në mishin dhe në gjakun e njeriut.

Le të marrim një puntor, cilindo qoftë, për shembull, një endës. Kapitalisti i jep atij avlëmendin dhe fijet. Endsi fillon punën dhe fijet shndërrohen në pëlhurë. Kapitalisti e merr pëlhurën dhe e shet, ta zamë, 20 marka. A është paga e endsit një pjesë e pëlhurës, një pjesë e 20 markave, një pjesë e produktit të punës së tij? Aspak. Endsi e mori pagën e tij shumë kohë përpara se të shitej pëlhura, dhe ndoshta shumë kohë përpara, se pëlhura t'endej. Pra, kapitalisti nuk e paguen pagën me të hollat, që do të marri nga pëlhura, por e paguen me të hollat që kish rezervë. Ashtu sikurse avlëmendi dhe fijet nuk janë produkte t'endsit, të cilat ia dha borgjezi, pokështu nuk janë produkt i tij edhe mallnat që ai merr si shkëmbim për mallin e tij, fuqin punuese. Mund të ndodhi që borgjezi të mos gjejë fare blemës për pëlhurën e vet. Mund të ndodhi që nga shitja e pëlhurës ai të mos nxjerri as të hollat e mëditjes. Mund të ndodhi që ai ta shesë pëlhurën shumë më tepër në krahasim me shpërblimin që i ka dhanë endsit. Të gjitha këto endsit nuk i interesojnë aspak. Me një pjesë të pasunisë së tij, që i takon, të kapitalit të tij, kapitalisti blen fuqin punuese t'endsit, ashtu sikurse me pjesën tjetër të kapitalit të vet ka blerë landën e parë fijet dhe veglën e punës — avlëmendin. Dhe mbasi i blen të gjitha këto, këtu hyn

edhe fuqija punuese e domosdoshme, Për prodhimin e pëlhurës, — ai tash prodhon vetëm me landa të para dhe me mjete të veta për punë. Natyrisht, në mjetet e punës tash hyn edhe endsi ynë i mirë, i cili ashtu sikurse edhe avlëmendi, nuk ka pjesë në produktin ose në çmimin e tij.

Prandej, paga nuk është pjesë e puntorit në mallin e prodhuem prej tij. Paga është një pjesë e mallit, që ekziston qysh më parë me të cilën kapitalisti blen një sasi të caktueme fuqije punuese prodhuese.

Pra, fuqija punuese është mall, të cilin zotnuesi i tij puntori me mëditje, ia shet kapitalit. Pse e shet ai? Për të jetue.

Por çfaqje e fuqis punuese në veprim, puna, është veprimtaria jetsore e vetë puntorit, është çfaqja e jetës së tij. Dhe këtë veprimtari jetsore puntori ia shet një tjetri për të sigurue mjetet e nevojshme të jetës. Pra, veprimtaria jetsore e tij për të është vetëm një mjet, që i jep atij mundsi për të jetue. Ai punon për të jetue. Ai madje nuk e quen punën si pjesë të jetës së tij; përkundrazi, për të puna don të thotë të sakrifikojë jetën e tij. Puna është mall, që ai ia ka shitë një tjetri. Prandej edhe produkti i primtaris së tij nuk është qëllimi i veprimtaris së tij. Për vehten e tij puntori nuk prodhon as mëndafshin që end, as arin që nxjerr nga miniera, as pallatin që ndërton. Për vehten e tij ai prodhon pagën, kurse mëndafshi, ari, pallati për të shndërrohen në një sasi të caktueme mjetesh për jetesë, ndoshta, në këmishë pambuku, në monedhë bakri ose banesë në ndonji podrum. Po puntori, i cili end, tjerr, shpon, gëdhend, ndërton, gërmon, thyen gurë, mban ngarkesa 12

orë në ditë, — a mundet vallë që ai kët endje, tjerre, shpuemje, gëdhendje ndërtim, gërmim, kët thyemje të gurëve për 12 orë ta quejnë si çfaqjen e jetës së tij, si jetë e tij? Përkundrazi. Jeta për të fillon atëherë, kur kjo veprimtari, pushon, në tryezën e bukës, në kafe, në shtrat. Puna e 12 orëve për të nuk ka kuptim si endje, si tjerre, si shpuemje etj., por si fitim për të sigurue hajen, kafen dhe fjetjen. Sikur krymbi i mëndafshit t'endte për të jetue si krymb, ai do t'ishte një puntuer i vërtetë me mëditje. Fuqija punuese nuk ka qenë gjithnjë mall. Puna nuk ka qenë gjithnjë punë me mëditje, dmth. punë e lirë. Skllavi nuk ia shiste fuqin e tij punuese skllavopronarit poashtu sikurse kau nuk ia shet katundarit punën e tij. Skllavi i shitej të zotit një herë e përgjithmonë së bashku me fuqin e tij punuese. Ai është mall, që mund të kalojë nga duert e një pronari në duert e një tjetri. Ai vetë është mall, por fuqija punuese nuk është mall i tij. Bujkorobi shet vetëm një pjesë të fuqisë së tij punuese. Ai nuk merr shpërblim nga pronari i tokës; por përkundrazi, pronari i tokës merr prej tij haraç.

Bujkorobi i takon tokës dhe i sjell fryte pronarit të saj. Puntori i lirë, përkundrazi, shet vetveten pjesë-pjesë. Për ditë në tregun publik puntori ia shet 8, 10, 12, 15 orë të jetës së tij dhe ia shet atij, që paguen më shumë: pronarit të landëve të para, të veglave të punës dhe të mjeteve për jetesë, dmth. kapitalistit. Puntori nuk i takon as ndonjë pronari, as tokës, por 8, 10, 12, 15 orë të jetës së tij të përditshme janë t'atij që i blen. Puntori ikën kur të dojë nga kapitalisti, te i cili është pajtue, dhe kapitalisti e nxjerr ate nga puna kur t'i pëlqejë, sa herë që puntori nuk i sjell

fitim ose nuk i sjell at fitim, që kapitalisti priste. Por, puntori, për të cilin i vetmi burim i t'ardhunave është shitja e fuqis punuese, nuk mund të heqi dorë nga e gjithë klasa e blemësve, dmth. nga klasa e kapitalistëve, pa heqë dorë nga jeta. Ai nuk i takon atij ose këtij kapitalisti, por i takon klasës kapitaliste në tansi; dhe tash është puna se tij të gjejë mështeri, dmth. të gjejë blemës për vedit në këtë klasë kapitaliste.

Mandej, para se të shohim me hollsi marrëdhënjet midis kapitalit dhe punës me mëditje, do të flasim shkurtimisht për kushtet më të përgjithshme, të cilat luejnë rol në përcaktimin e pagës.

Paga, sikurse pamë, është çmimi i një malli të caktuar, i fuqis punuese. Prandaj paga përcaktohet po nga ato ligje, që përcaktojnë edhe çmimin e çdo malli tjetër. Pra: si përcaktohet çmimi i ndonjë malli?

II

Si përcaktohet çmimi i mallit?

Përcaktohet nga konkurrenca midis blemësve dhe shitësve, nga raporti midis kërkesës dhe ofertës, midis nevojës dhe sasis së mallnave, që duhen për të plotsuar ato. Konkurrenca, që përcakton çmimin e një malli, ka tri anë.

I njëjti mall ofrohet nga shitës të ndryshëm. Ai, që shet mallna të së njëjtës cilsi më lirë, se gjithë të tjerët, ai patjetër do t'i zhduki shitsit tjerë dhe do të sigurojë për

vedi një shitje më të madhe. Pra, shitsit luftojnë midis tyre për mundsin e shitjes, për tregun. Secili prej tyre don të shesi, të shesi sa më shumë, dhe mundsisht të shesi vetëm ai, tue zhdukë shitsit tjerë. Prandej njani shet më lirë se tjetri. Pra, egziston konkurrenca midis shitësve, e cila e ul çmimin e mallrave, që ofrojnë ata.

Por egziston edhe konkurrenca midis blemësve e cila nga ana e saj, i ngren çmimet e mallrave t'ofrueme.

Ekziston, më në fund, konkurrenca midis blemësve dhe shitësve; një palë don të blejë sa më lirë, pala tjetër don të shesi sa të jetë e mundur ma shtrejtë. Rezultati i kësaj konkurrenca midis blemësve dhe shitësve mvaret nga raporti i dy palëve konkurrenca që përmendëm më nalt, dmth, nga fakti, se ku është konkurrenca më e fortë, n'anën e blemësve apo në anën e shitësve. Industria nxjerr në shesh të luftës dy ushtri, njanën kundër tjetrës, dhe në radhët e secilës prej tyre zhvillohet një luftë midis trupave të veta. Fitorja është n'anën e asaj ushtrieje, në radhët e së cilës ka më pak përleshje.

Ta zamë, se treg ndodhen 100 dengje me parnbuk ndërsa në të njëjtën kohë blemës ka për 1000 dengje. kët rast, pra, kërkesa është dhetë herë më e madhe se oferta. Prandej konkurrenca midis blemësve do të jetë shumë e fortë; secili prej tyre do të përpiqet me marrë për vedi një deng, por ndoshta edhe të 100 dengjet. Kët shembull nuk e marrim pse na teket. Në historin e tregtis ne kemi përjetue perioda të tilla me prodhim të paktë pambuku, kur disa kapitalistë, mbasi merreshin vesh midis tyre, përpiqeshin të blejnë jo

100 dengje, por gjithë pambukun, që kishte në botë. Pra, në rastin, që përmendëm, çdo blemës do të përpiqet ta zmbrajë tjetrin, tue dhanë për një deng me pambuk një çmim relativisht më të madh. Shitsit e pambukut, tue pa luftën shumë të ashpër vllavrasëse në radhët e ushtrisë kundërshtarë dhe tue qenë plotsisht të sigurtë, se do t'i shesin të 100 dengjet, do të kenë kujdes të mos hyjnë në përleshje midis tyre për t'i ulë çmimet e pambukut në një çast, kur kundërshtarët e tyre janë në garë për t'i ngritë çmimet. Kështu, pra, pa pritë e pa kujtue, në kampin e shitësve vendoset paqja. Ata, si një njeri i vetëm, u qëndrojnë përballë blemësve, kryqzojnë duert si filozofë, dhe kërkesat e tyre nuk dop të kishin asnjë kufi sikur ofertat e blemësve edhe më kambëngulës, nga ana e tyre, të mos kishin kufij mjaft të caktuem.

Pra, nëqoftëse oferta e një malli është më e vogël se kërkesa për to, konkurrenca midis shitësve të tij është shumë e paktë ose s'ka fare. Sa më shumë paksohet konkurrenca midis shitësve, aq më shumë rritet konkurrenca midis blemësve. Rezultati është, se çmimet e mallave ngrihen në një shkallë pak a shumë të madhe.

Dihet, se më shpesh ndodh rasti i kundërt, i cili jep pasoja të kundërta: ofertë shumë më të madhe, se kërkesa, konkurrencë e dëshprueme midis shitësve, mungesë blemsish, shitje mallnash me çmime shumë të ulta: Po ç'është thotë ngritje dhe ulje e çmimeve, çmim i naltë dhe çmim i ulët? Kokrra e ranës, po ta shohish me mikroskop, duket e naltë, ndërsa kulla, në krahasim me mallin, duket e ulët. Dhe në qoftëse çmimi caktohet nga raporti midis kërkesës

dhe ofertës, nga se caktohet atëherë raporti midis kërkesës dhe ofertës?

Le të pyesim borgjezin e parë, që hasim. Ai, pa u mendue aspak, dhe, si një Aleksandër i Madh i dytë, do ta zgjidhi menjherë ket nyje metafizike, tuc përdorë tabelën e shumzimit. Nëqoftëse na thotë, se prodhimi i mallit, që unë shes, më ka kushtue 100 marka, ndërsa kur unë e shes ate, marr 110 marka, — natyrisht, mbas vjeti, — ky është një fitim i mirë, i ndershëm, i ligjshëm. Por nëqoftëse kur e shkëmbej marr 120, 130 marka, ky është një fitim i madh, dhe, më në fund, nëqoftëse do të merrshe 200 marka, ky do të ishte një fitim i jashtëzakonshëm, shumë i madh. Pra, cila është masa, me cilën borgjezi mat fitimin? masë e tillë janë shpenzimet e prodhimit të mallit të tij. Nëqoftëse, kur ai e shkëmbeu mallin e tij, merr sasi mallnash të tjera, prodhimi i të cilave ka kushtue më pak se prodhimi i mallit të tij, atëherë ai humbet. Nëqoftëse, kur ai e shkëmbeu mallin e tij, merr një sasi mallnash, prodhimi i të cilave ka kushtue më shumë atëherë ai fiton. Uljen ose ngritjen e fitimit të tij ai e mat me sasin e gradëve, që ka vlefte e shkëmbimit të mallit të tij mbi zero ose nën zero mbi ose nën shpenzimet e prodhimit. — dmth., mbi ose nën shpenzimet e prodhimit.

Pra, pamë se si ndryshimi i raportit midis kërkesës dhe ofertës shkakton herë ngritjen, herë ramien e çmimeve, herë çmime të nalta, herë çmime të ulta. Sikur për shkak se oferta është e vogël ose kërkesa është shumë e madhe, çmimi i një malli ngrihet shumë, atëherë, po në këtë masë, ulet në mënyrë të pashmangshme çmimi i ndonjë malli tjetër,

sepse çmimi i mallit shpreh në të holla vetëm raportin, në të cilin mallnat tjera shkëmbehen me të. Nëqoftëse, për shembull, çmimi i një kuti pëlhurë mëndafshi ngrihet nga 5 në 6 marka, atëherë çmimi i argjendit, në krahasim me pëlhurën e mëndafshit, ulet dhe, në krahasim me pëlhurën e mëndafshit, ulen gjithashtu edhe çmimet, që mbeten të pandryshueme të të gjitha mallnave tjera. Tash, për të marrë të njëjtën sasi pëlhure të mëndafshit, duhet dhanë një sasi më e madhe mallnash. Cilat janë pasojat, që sjell ngritja e çmimit të mallit? Nji shumicë kapitalesh do të derdhet në degën që lulzon t'industris, dhe kjo derdhje e kapitaleve në degën ma me leverdi t'industris do të vazhdojë derisa fitimi në këtë degë të bjeri deri në nivelin e zakonshëm, ose, më mirë, deri sa çmimi i produkteve të saj, për shkak të superprodhimit, të bjeri nën shpenzimet e prodhimit.

Përkundrazi, nëqoftëse çmimi i një malli bie nën shpenzimet e prodhimit të tij, atëherë kapitalet do të hiqen nga prodhimi i këtij malli. Përvec rastit, kur një degë e industris nuk u përgjigjet ma kërkesave të kohës dhe prandaj duhet të zhduket, prodhimi i një malli, dmth. oferta e tij, për shkak të largimit të kapitaleve, do të paksohet derisa ajo të përputhet me kërkesën, dmth. derisa çmimi i mallit të ngrihet përsëri në nivelin e shpenzimeve të prodhimit, ose, ma mirë, derisa oferta të bjeri nën kërkesën, dmth. derisa çmimi i mallit të ngrihet përsëri mbi shpenzimet e tij të prodhimit, sepse çmimi i përditshëm i një malli është gjithnjë nënt ose ma posht, se shpenzimet e tij të prodhimit.

Kështu, shohim, se kapitalet hiqen ose derdhen pa rreshtë nga një degë e prodhimit në tjetrën. Çmimi i naltë shkakton një derdhje të madhe, ndërsa çmimi i ulët shkakton një heqje të madhe të kapitaleve.

Tue e pa çashtjen nga një pikëpamje tjetër ne mund të tregojmë, se jo vetëm oferta, por edhe kërkesa caktohet nga shpenzimet e prodhimit. Por kjo do të na çonte shumë larg nga çashtja jonë.

Tash sapo pamë se si lëkundjet e kërkesës dhe t'ofertës e çojnë gjithnjë çmimin e mallit në shpenzimet e prodhimit. Në realitet, çmimi i vërtetë i mallit është gjithnjë mbi ose nën shpenzimet e prodhimit; por ngritjet dhe uljet mbulojnë njana tjetrën, kështu që, mbrenda një kohe të caktuar, po të marrim parasysh në tansi gjendjen e mirë ose të keqe t'industris, mallnat shkëmbehen midis tyre simbas shpenzimeve të prodhimit, pra, çmimi i tyre caktohet nga shpenzimet e prodhimit.

Ky caktim i çmimit nga shpenzimet e prodhimit nuk duhet kuptuar ashtu siç e kuptojnë ekonomistët. Ekonomistët thonë, se çmimi mesatar i mallave është barazi me shpenzimet e prodhimit; dhe kjo, simbas tyre, është ligj. Lëvizjen anarkike, në të cilën ngritja e çmimit mbulohet nga ramja e tij, ndërsa ramja mbulohet nga ngritja, ata e quajnë si një gjë të rastit. Po kështu, siç bëjnë ekonomistët tjerë mund të quhen ligj edhe lëkundjet e çmimeve ndërsa caktimi i tyre nga shpenzimet e prodhimit — si një gjë e rastit. Në të vërtetë, vetëm me anën e këtyre lëkundjeve, të cilat, po t'i shohim s'afërmi, sjellin me vehte

shkatrimin më të tmershëm dhe trondisin si tërmete shoqin borgjeze nga themelet, vetëm me anën e këtyne lëkundjeve çmimet përcaktohen nga shpenzimet e prodhimit. Tanë lëvizja e këtij çrregullimi është rregull i tij. Në këtë anarki industriale, në këtë lëvizje në rreth, konkurenca, si të thuesh, korpenson një ekstrem me një tjetër. Ne shohim, pra, se çmimi i mallit caktohet nga shpenzimet e tij të prodhimit, në mënyrë të tillë, që periodat, kur çmimi i një malli të caktuem është më i madh se shpenzimet e tij të prodhimit, kompensohen nga periodat, kur ai është më i vogël, se shpenzimet e tij të prodhimit, dhe anasjelltas. Natyrisht, kjo nuk ka vleftë për çdo produkt industrial të veçantë, por vetëm për një degë të tanë t'industris; pra, kjo nuk ka vleftë për një kapitalist të veçantë, por vetëm për gjithë klasën e kapitalistëve në tansi.

Përcaktimi i çmimit nga shpenzimet e prodhimit është barazi me përcaktimin e çmimit nga koha e punës, që duhet për prodhimin e një malli, sepse shpenzimet e prodhimit përbahen: 1) nga landa e parë dhe nga konsumimi i veglave të punës, dmth. nga produktet e industris, prodhimi i të cilave ka kushtue një sasi të caktueme ditësh pune dhe që prandaj përfaqsojnë një sasi të caktueme kohe pune, dhe 2) nga puna e drejtpërdrejtë, si masë e së cilës është gjithashtu koha.

Po ato ligje të përgjithshme, që përgjithsisht rregullojnë çmimin e mallnave, po ato ligje rregullojnë, sigurisht, edhe pagën, çmimin e punës.

Paga do të ngrihet ose do të bjeri në përputhje me raportin midis kërkesës dhe ofertës, në përputhje me konkurrencën midis blemësve të fuqis puntore, kapitalistëve dhe shitësve të fuqis punuese, puntorëve. Lëkundjet e pagës përgjithsisht u përgjigjen lëkundjeve të çmimeve të mallrave. Por mbrenda kufijve të këtyne lëkundjeve çmimi i punës caktohet nga shpenzimet e prodhimit, nga koha e punës, që duhet për ta prodhues këto mall, fuqin punuese.

Ç'janë shpenzimet e prodhimit të fuqis punuese?

Këto janë shpenzimet, që duhert për të rrujtë puntorin si puntor dhe për ta formue si puntor.

Prandej, sa më pak kohë duhet për të mësue një punë, aq më të vogla janë shpenzimet e prodhimit të puntorit, aq ma i ulët është çmimi i punës së tij, është paga e tij. N'ato degë t'industri, ku pothuajse nuk duhet asnjë kohë për mësime dhe ku mjafton vetëm ekzistenca fizike e puntorit, shpenzimet e prodhimit, që duhen për formimin e tij, pothuajse janë barazi vetëm me mallrat, që duhen për të rrujtë jetën dhe aftsit e tij për punë. Prandej çmimi i punës së tij caktohet nga çmimi i mjeteve të domosdoshme për jetesë.

Por këtu duhet pasë parasysh edhe një rrethanë. Fabrikanti, kur llogarit shpenzimet e tij të prodhimit dhe, në bazë të tyre, edhe çmimin e produkteve, në to fut konsumimin e veglave të punës. Nëqoftëse, për shembull, maqina atij i kushton 1000 marka dhe konsumohet në dhjetë vjet, çdo vjet ai fut në çmimin e mallit 100 marka, në mënyrë që

mbas dhetë vjetëve të ketë mundsi ta zavendsojë maqinën e konsumueme me një maqinë të re. Po kështu në shpenzimet e prodhimit të fuqis puntore të thjeshtë duhet të hyjnë edhe shpenzimet për vazhdimin e gjinis, të cilat i japin mundsi klasës puntore të shtohet dhe të zavendsojë puntorët, që janë bënë të paaftë për punë, me puntorë të rij. Pra, konsumimi i puntorit llogaritet po në atë mënyrë si edhe konsumimi i maqinës.

Pra, shpenzimet e prodhimit të fuqis puntore të thjeshtë janë barazi me shpenzimet e ekzistencës së puntorit dhe të vazhimit të gjinis së tij. Çmimi i këtyne shpenzimeve të ekzistencës dhe të vazhimit të gjinis përban pagën, paga e përcaktueme në këtë mënyrë quhet minimum i pagës. Ky minimum i pagës, si përgjithsisht edhe caktimi i çmimit të mallnave nga shpenzimet e prodhimit, nuk ka vleftë për individin e veçantë, por për të gjithë gjinin. Puntorë të veçantë dhe miliona puntorë marrin ma pak, se sa u duhet për të pasë mundsi që t'ekzistojnë dhe të vazhdojnë gjinin e tyre, por paga e të gjithë klasës puntore, mbrenda kufijve të këtyne lëkundjeve, asht barazi me këtë minimum.

Tash që sqaruem ligjet ma të përgjithshme, që rregullojnë pagën, si dhe çmimin e çdo malli tjetër, mund ta shohim ma afër objektin tonë.

III

Kapitali përbahet nga landë të para, nga vegla pune dhe nga mjete të ndryshme jetsore, të cilat përdoren për të prodhues landë të para të reja, vegla pune të reja dhe mjete të reja jetese. Të gjitha këto pjesë përbase të kapitalit janë krijime të punës prodhuese të punës, janë punë e akumuluese. Kapitali është punë e akumuluese, që shërben si mjet për një prodhim të ri.

Kështu thonë ekonomistët.

Ç'është zezaku skllav? Një njeri i racës së zezë. Një shpjegim vlen sa edhe tjetri.

Zezaku është zezak. Vetëm në disa marrëdhënie të caktueme ai bahet skllav. Maqina tjerrese e pambukut është maqinë për të tjerë pambuk. Vetëm në disa marrëdhënie të caktueme ajo bahet kapital. Po ta heqim nga këto marrëdhënie, ajo gjithashtu nuk është kapital, ashtu si ari në vetëvehte nuk është të holla ose sheqeri nuk është çmimi i sheqerit.

Në prodhim njerzitet vepronë jo vetëm mbi natyrën, por edhe mbi njani tjetrin. Ata nuk mund të prodhojnë pa u bashkuar në një farë mënyre për veprimtari të përbashkët dhe për të shkëmbye me njani tjetrin veprimtarin e tyre. Për të prodhues, njerzitet hyjnë në lidhje me marrëdhënie të caktueme, dhe vetëm nëpërmjet këtyre lidhjeve dhe marrëdhënieve shoqërore ndodh veprimi i tyre mbi natyrën, bahet prodhimi.

Simbas karakterit të mjeteve të prodhimit, këto marrëdhaje shoqnore, që i bashkojnë prodhuesit me njani tjetrin, këto kushte, në të cilat ata shkëmbejnë punën e tyre dhe marrin pjesë në prodhimin në tansi, do të jenë, sigurisht të ndryshme. Me çpikjen e armës së re të luftës, armës me zjarr, gjithë organizimi i mbrendshëm i ushtrisë u ndryshue në mënyrë të pashmangshme, u transformuen edhe marrëdhajet, në bazën e të cilave individët e veçantë përbajnë ushtrinë dhe mund të veprojnë si ushtri, ndryshoi gjithashtu edhe raporti i ushtrive të ndryshme midis tyre.

Pra, marrëdhajet shoqnore, në të cilat individët, prodhojnë marrëdhajet shoqnore të prodhimit, ndryshohen, transformohen me ndryshimin dhe me zhvillimin e mjeteve materiale të prodhimit, e forcave prodhuese. Marrëdhajet e prodhimit në tansi përbajnë ato, që quhen marrëdhaje shoqnore, shoqni dhe formojnë një shoqni që gjindet në një shkallë të caktueme të zhvillimit historik, në shoqni me një karakter të veçantë dallues. Shoqnija e vjetër, shoqnija feudale, shoqnija borgjeze janë tansi të tilla marrëdhajesh prodhimi, dhe secila prej tyre shënon njëkohsisht një shkallë të veçantë në zhvillimin historik të njerzimit.

Edhe kapitali është marrëdhaje shoqnore prodhimi. Ajo është marrëdhaje borgjeze prodhimi, marrëdhaje prodhimi i shoqnis borgjeze. Mjetet e jetesës, veglat e punës, landa e parë, që përbajnë kapitalin, — të gjitha këto vallë a nuk janë prodhues dhe akumulue në kushte të caktueme shoqnore, në marrëdhaje të caktueme

shoqnore? Vallë a nuk përdoren ato për prodhimin e ri në kushte të caktueme shoqnore, në marrëdhnje të caktueme shoqnore? Dhe vallë a nuk është ky karakter i caktuem shoqnor, që i shndërron në kapital produktet, të cilat shërbejnë për prodhimin e ri?

Kapitali nuk përbàhet vetëm nga mjetet e jetesës, nga veglat e punës dhe nga landa e parë, as edhe vetëm nga produkte materiale; ai përbàhet gjithashtu nga vlefte shkëmbimi. Të gjitha produktet, nga të cilat përbàhet kapitali, janë mall. Kapitali, pra, është vetëm një shumë produktesh materiale; ai është edhe një shumë mallnash, vleftash shkëmbimi, madhsish shoqnore.

Edhe nëqoftëse ne marrim pambuk në vend të leshit, oriz në vend të drithit, vapore në vend të hekurudhave, kapitali mbetet po ai, poqese pambuku, orizi, vaporet — mish i kapitalit — kanë po at vleftë shkëmbimi, po at çmim, që kanë edhe leshi, drithi, hekurudha, në të cilat ai mishnohej më parë. Mishi i kapitalit mund të ndryshojë vazhdimisht, ndërsa vetë kapitali të mos pësojë as ndryshimin ma të vogël.

Por nëqoftëse çdo kapital është një shumë mall nash, dmth. një shumë vleftash shkëmbimi, çdo shumë mallnash, çdo shumë vleftash shkëmbimi nuk është kapital.

Çdo shumë vleftash shkëmbimi është një vleftë shkëmbimi. Çdo vleftë shkëmbimi e veçantë asht një shumë vleftash shkëmbimi. Për shembull, një shtëpi, që kushton 1000 marka, është një vleftë shkëmbimi prej 1000 markash. Një copë letër, që kush ton 1 pfennig, është një

shurnë vleftash shkëmbimi 100/100 prej të pfennigut. Produktet, që mund të shkëmbehen me produkte tjera, janë mallna. Raporti i caktuem, simbas të cilit ata shkëmbehen, përbajnë vleftën e shkëmbimit të tyre, ose poqese ajo shprehet në të holla, përban çmimin e tyre. Sasija e këtyne produkteve nuk mund ta ndryshojë aspak cilsin e tyre për që qenë mall, ose vleftë shkëmbirni, ose për të pasë një çmim të caktuem. Druni mbetet dru, pamvarsisht nëse ai është i madh apo i vogël. Vallë a mund të ndryshojë karakteri i hekurit si mall, si vleftë shkëmbimi, poqese në ate nuk e shkëmbejmë me produktet tjera në derhem, por e shkëmbejmë në kuintal? Simbas sasis së tij, hekuri është një mall me vleftë më të madhe ose më të vogël, me çmim më të lartë ose më të ulët.

Pra, si bahet kapital një sasi e caktueme mallnash, vleftash shkëmbimi?

Ajo bahet kapital, sepse si forcë shoqnore e pamvarun, dmth. si forcë, që i përket një pjese të shoqnis, ruhet dhe shumzohet me anë të shkëmbimit drejtpërdrejt me fuqin punuese të gjallë. Egzistenca e një klase, që nuk ka asgjë tjetër, përveç aftsis për punë, është kusht i domosdoshëm për kapitalin.

Vetëm sundimi i punës s'akumulume, i punës së kalueme, i punës së materializume mbi punën e tashme, mbi punën e gjallë, e shndërron punën akumulume në kapital.

Thelbi i kapitalit nuk qëndron në faktin, se puna e akumuluar e shërben punës së gjallë si mjet për një prodhim të ri. Thelbi i tij qëndron në faktin, se puna e gjallë e shërben punës së akumuluar si mjet për të rrujtë dhe për të shtuar vlefën e saj të shkëmbimit.

Ç'ndodh në shkëmbimin midis kapitalistit dhe puntorit me mëditje? Në veprimtarinë prodhuese të puntorit, forcën krijuese, me të cilën puntori jo vetëm zavendson atë, që konsumon, por i jep punës s'akumuluar një vlefë ma të madhe, se vlefë, që ajo kishte ma parë. Puntori merr nga kapitalisti një pjesë të mjeteve të jetesës, që ekzistojnë. Pse i duhen atij këto mjete jetese? Për t'i konsumuar. Por kur unë i konsumoj mjetet e jetesës, ato për mua janë të humbura një herë e përgjithmonë, nëqoftëse unë kohën, gjatë së cilës këto mjete më mbajtën gjallë, nuk do ta përdor për të prodhuar mjete të reja jetese, dmth. për të krijuar me punën time, gjatë konsumimit, vlefë të reja për të zavendosur vlefat, që u zhdukën si pasojë e konsumit. Po pikërisht këtë forcë fisnike riprodhuese i jep puntori kapitalit si shkëmbim për mjetet e jetesës, që merr prej tij. Pra, për atë vetë ajo është e humbun.

Le të marrim një shembull të tillë: një fermer i jep argatit të tij 5 grosh argjendi në ditë. Për këto 5 grosh argjendi argati punon në tokën e fermerit gjithë ditën, duke i siguruar atij në këtë mënyrë një t'ardhun prej 10 grosh argjendi. Fermeri nuk merr vetëm vlefën, që i ka dhënë argati, por e dyfishon atë. Pra, 5 grosh argjendi që i dha argatit, ai i përdori, i konsumoi me fitim, në mënyrë prodhuese. Me këta 5 grosh argjendi ai bleu punën dhe

forcën e argatit, të cilat prodhojnë produkte bujqesore me një vleftë dy herë më të madhe dhe i shndërrojnë 5 grosh argjendi në 10 grosh argjendi. Argati, në vend të forcës së tij prodhuese, veprimin e së cilës ia dha pikërisht fermerit, merr 5 grosh argjendi, dhe i shkëmben ata me mjete jetese, të cilat i konsumon më shpejt, ose më ngadalë. Pra, këta 5 grosh argjendi janë përdorë në mënyrë të dyfishtë: mënyrë prodhuese për kapitalin, sepse ai i shkëmbeu ata me fuqin punuese⁷, e cila i dha atij 10 grosh argjendi, dhe në mënyrë jo prodhuese për puntorin, sepse ai i shkëmbeu ata me mjete jetese, që u zhdrukën për gjithnjë, dhe vleftën e të cilave ai mund ta marrë përsëri vetëm në rast se ai përsërit të njëjtin shkëmbim me fermerin. Pra kapitali kërkon si kusht punën me mëditje, ndërsa puna me mëditje kërkon si kusht kapitalin. Ata në mënyrë reciproke kondicionojnë njëri tjetrin; ata në mënyrë reciproke lindin njëri tjetrin.

Në fabrikën e pambukut puntori e aprovon vllë vetëm stofna prej pambuku? Jo, ai prodhon kapital, ai prodhon vlefta, që do të shërbejnë përsëri për t'urdhnuë punën e tij, për të krijuë me të vlefta të reja.

Kapitali mund të rritet vetëm po të shkëmbehet me fuqin puntore, vetëm po të prodhojë punë me mëditje. Fuqija punuese e puntorit me mëditje mund të shkëmbehet me kapital vetëm në rast se rrit kapitalin dhe forcon pushtetin,

⁷ Në këtë vend termi "fuqi punuese" nuk është vu nga Engelsi, por gjendet në tekstin e botuem nga Marksi në "Gazetën e Re Renane". Red.

që atë e skllavnon. Pra, rritja e kapitalit asht rritje e proletariatit, dmth., e klasës puntore.

Pra, interesat e kapitalistit dhe të puntorit janë të njillojta, thonë borgjezët dhe ekonomistët e tyne. Dhe me të vërtetë! Puntori vdes po të mos gjejë punë te kapitali. Kapitali vdes po të mos shfrytzojë fuqin punuese, ndërsa për ta shfrytzuë ai duhet ta blejë ate. Sa më shpejt të shtohet kapitali i caktuem për prodhim, kapitali prodhues, sa më shumë, pra, të lulzojë industria, sa më shumë të pasunohet borgjezija, sa më mirë të shkojnë punët, aq më shumë puntorë i duhen kapitalistit, aq më shtrejtë e shet vehtëvehten puntori.

Pra, si kusht i domosdoshëm për një gjendje pak a shumë të durueshme nga puntori është që kapitali prodhues të rritet sa të jetë e mundun ma shpejt.

Po ç'do të thotë të rritet kapitali prodhues? Kjo do të thotë të rritet pushteti i punës s'akumulueme mbi punën e gjallë, të rritet sundimi i borgjezis mbi klasën puntore. Ndërsa puna me mëditje, prodhon pasunin e huej, që sundon mbi të, forcën, që është anmiku i tij, kapitalin, nga ky i fundit ai merr mjetet për punë, dmth. mjetet e jetesës, me kusht që ky të bëhet përsëri një pjesë e kapitalit, një levë që ta shpejtojë përsëri rritjen e kapitalit.

Pohimi, se interesat e kapitalit dhe interesat e puntorit janë të njillojta, — në të vërtetë don të thotë vetëm, se: kapitali dhe puna me mëditje janë dy anë të të njëjtit raport. Njena anë kondicionon tjetrën, ashtu sic kondicionohen në

mënyrë reciproke njani me tjetrin fajdexhiu me ate, që i prish të hollat.

Deri sa puntori me mëditje është puntor me mëditje, fati i tij mvaret nga kapitali. Kjo është bashksija famëkeqe e interesave të puntorit dhe të kapitalistit.

IV

Poqese rritet kapitali, rritet edhe sasija e punës me mëditje, rritet numri i puntorëve me mëditje, me një fjalë, sundimi i kapitalit shtrihet mbi një sasi të madhe njerzish. Dhe le të marrin rastin ma të favorshëm; kur rritet kapitali prodhues, rritet edhe kërkesa për punë, pra, ngrihet edhe çmimi i punës, paga.

Sado e vogël që të jetë një shtëpi, për derisa shtëpijat rreth e rrotull janë dhe ato po aq të vogla, ajo i plotson të gjitha kërkesat shoqnore, që duhen për një shtëpi. Por kur pranë shtëpis së vogël, ngrihet një pallat, atëherë shtëpija e vogël bahet një kasollë. Tani shtëpija e vogël tregon, se i zoti i saj nuk ka asnjë pretendim, ose ka vetëm pretendime shumë modeste; dhe me zhvillimin e qytetnimit sado që të ngrihet një shtëpija e vogël, nëqoftëse pallati, që është pranë saj, ngrihet për një masë të barabartë ose edhe ma tepër, i zoti i shtëpis relativisht të vogël do ta ndjejë vehten, mbrenda katër mureve të tij, gjithnjë më ngushtë, do të jetë gjithnjë më i pakënaqun, ma i shtypun.

Rritja pak a shumë e ndieshme e pagës kërkon si kusht rritjen e shpejtë të kapitalit prodhues. Rritja e shpejtë e kapitalit prodhues shkakton gjithashtu një rritje po aq të shpejtë të pasunis, të Iluksit, të nevojave shoqnore dhe të kënaqsive shoqnore. Pra, ndonse kënaqsit e mundshme të puntorit shtohen, plotsimi shoqnor i tyre paksohet, në krahasim me kënaqsit e kapitalistit, që shtohen, të cilat puntori nuk mund t'i ketë, dhe në përgjithsi në krahasim me shkallën e zhvillimit të shoqnis. Nevojat dhe kënaqsit tona lindin nga shoqnia; prandej ne i masim ato në bazë të shoqnis dhe nuk i masim në bazë të mjeteve materiale, që duhen për t'i kënaqë ato. Meqenëse nevojat dhe kënaqsit tona kanë karakter shoqnor, ato janë relative.

Paga përgjithsisht nuk përcaktohet vetëm nga sasija e mallnave, që unë mund të marr si shkëmbim të saj. Ajo përmban raporte të ndryshme. Para së gjithash, puntori merr për fuqin e tij punuese një shumë të caktuar të hollash. A përcaktohet vallë paga vetëm nga ky çmim në të holla?

Në shekullin XVI, kur n'Amerikë u zbuluen miniera ma të pasuna dhe që mund të shfrytzoheshin ma lehtë, n'Evropë u rrit, sasija e arit dhe e argjendit në qarkullim. Si rrjedhim, vlefata e arit dhe e argjendit ra në krahasim me mallnat tjera, puntorët vazhduen të marrin për fuqin e tyre punuese të njajtën sasi argjendi në monedhë, që merrshin edhe ma parë. Çmimi në të holla i punës së tyre mbeti po ai, por, megjithatë, paga e tyre u paksue, sepse në shkëmbim me të njajtën sasi argjendi ata merrshin një sasi ma të vogël mallnash tjera. Kjo që një nga rrethanat, që

ndihmuen për rritjen e kapitalit, për ngritjen e borgjezis në shekullin XVI.

Le të marrim një rast tjetër. Në dimën të vjetit 1847, meqenëse të korrat nuk qenë të mira, çmimet e sendeve t'ushqimit të të nevojës së parë, drithit, mishit, tëlyenit, djathit etj. u ngritën. Po ta zamë, se puntorët do të merrshin për fuqin e tyre punuese të njëjtën shumë të hollash, që merrshin edhe ma parë, vallë paga e tyre a nuk do të binte? Sigurisht, do të binte. Me të njëjtën sasi të hollash ata do të merrshin ma pak bukë, mish etj. Paga e tyre nuk do të binte, sepse paksohej vlefata e argjendit, por sepse rritej vlefata e mjeteve të jetës.

Ta zamë, ma në fund, se çmimi në të holla i punës nuk ndryshon, ndërsa çmimet e të gjitha rnalnave bujqesore dhe industriale, për shkak të përdorimit të maqinave të reja dhe të një vjeti të mbarë bien. Tash, me të njëjtën sasi të hollash, puntorët mund të blejnë ma shumë mallna të ndryshme. Pra, paga e tyre rritet pikërisht sepse vlefata e saj në të holla nuk ndryshoi.

Pra çmimi në të holla i punës, paga nominale, nuk asht e njëjtë me pagën reale, dmth. me sasin e rnalnave, që shkëmbehen në të vërtetë me pagën. Prandej, kur flasim për ngritjen ose uljen e pagës, nuk duhet të marrim parasysh vetëm çmimin e punës në të holla, vetëm pagën nominale.

Por as me pagën nominale, dmth. me shumën e të hollave, për të cilën puntori shitet te kapitalisti, as me pagën reale,

dmth. me sasin e mallnave, që ai mund të blejë me këto të holla, nuk kufizohen ma rrëdhanjet, që përmban paga.

Përveç kësaj, paga përcaktohet, para së gjithash, nga raporti me fitimin e kapitalistit. Kjo asht paga e krahasueshme, relative.

Paga reale shpreh çmimin e punës në raport me çrnimin e mallnave tjera, kurse paga relative shpreh pjesën e vleftës së krijueme rishtazi, që i takon punës së gjallë në krahasim me pjesën, që i takon punës s'akumulueme, kapitalit.

Ma sipër, në f. 23⁸, ne thamë se: “Paga nuk asht pjesë e puntorit në mallin e prodhuem prej tij. Paga asht një pjesë e mallit, që ekziston qysh ma parë, me të cilën kapitalisti blen një sasi të caktueme fuqije punuese prodhuese”. Por kapitalisti duhet ta zavendsojë përsëri këtë pagë me të hollat, që do të marri nga shitja e produktit të krijuem nga puntori; ai duhet ta zavendsojë në mënyrë t'atillë që, si rregull atij t'i mbetet edhe një tepricë mbi shpenzimet e prodhimit të bame prej tij, një fitim. Çmimi i shitjes së mallit të prodhuem nga puntori, për kapitalistin, ndahet në tri pjesë: e para zavendsimi i çmimit të landës së parë, që ai ka parapague, si dhe zavendsimi i veglave, maqinave e mjeteve tjera të punës të konsumueme, që i ka parapague gjithashtu; e dyta zavendsimi i pagës së parapagueme nga kapitalisti, dhe, e treta, teprica mbi këto, fitimi i kapitalistit. Ndërsa pjesa e parë zavendson vetëm vleftat, që kanë ekzistue ma parë, asht e qartë se si zavendsimi i

⁸ Shih. f.23 të këtij botimi Red.

pagës, ashtu edhe teprica, që përban fitimin e kapitalistit, dalin krejtësisht nga vleftha e re, që krijohet nga puna e puntorit dhe që i shtohet vleftës së landës së parë. Dhe në këtë kuptim, për t'i krahasue midis tyre, ne mund t'i quejmë si pagën, ashtu edhe fitimin si pjesë të produktit të puntorit.

Paga reale mund të mos ndryshojë, madje ajo mund edhe të ngrihet dhe megjithkëto paga relative mund të bjeri. Ta zamë, Për shembull, se çmimi i të gjitha mjeteve të jetës ka ra në $2/3$, kurse paga ditore ka ra vetem $1/3$, të themi nga 3 marka në 2 marka. Ndonse me këto 2 marka puntori mund të blejë një sasi ma të madhe mallnash, se sa blente ma parë me 3 marka, megjithatë, në krahasim me fitimin e kapitalistit, paga e tij asht paksue. Fitimi i kapitalistit (i fabrikantit, për shembull) asht shtue 1 markë, që don të thotë, se për një sasi ma të vogël vleftash shkëmbimi, që fabrikanti i paguen puntorit, ky duhet te prodhojë një sasi vleftash shkëmbimi ma të madhe se ma parë. Pjesa, që i takon kapitalit, në krahasim me pjesën, që i takon punës, u rrit. Pabarazija në ndamjen e pasunis shoqnore midis kapitalit dhe punës asht shtruar edhe ma shumë. Kapitalisti me të njajtin kapital komandon një sasi ma të madhe pune. Pushteti i klasës kapitaliste mbi klasën puntore asht shtue, gjendja shoqnore e puntorit asht keqsue, ka zbritë një shkallë ma poshtë, në krahasim me gjendjen e kapitalistit.

Cili asht, pra ligji i përgjithshëm, që përcakton ngritjen e zbritjen e pagës dhe të fitimit në krahasim me njëri tjetrin?

Paga dhe fitimi janë në përpjestim të zhdrejta me njani tjetrin. Pjesa e kapitalit, fitimi, rritet po n'at përpjestim, në të cilin paksohet pjesa e punës, paga ditore, dhe anasjelltas. Fitimi rritet aq sa paksohet paga, dhe paksohet aq sa rritet paga.

Mund të na kundërshtojnë, ndoshta tue thanë se kapitalisti mund fitojë nga shkëmbimi i levërdishëm i produkteve të tij me kapitalistët tjerë, nga rritja e kërkesës për mallin e tij, Për shkak se janë hapë tregje të reja ose janë shtue përkohsisht nevojat e tregjeve të vjetra e tjera; se fitimi i një kapitalisti, pra, mund të rritet në kurriz të kapitalistëve tjerë, pamvarsisht nga ngritja ose ulja e pagës, e vleftës së shkëmbimit të fuqis punuese; ose se fitimi i kapitalistit mund të rritet në saje të pamvarsimit të veglave të punës, të një përdorimi të ri të forcave të natyrës, e tjera.

Para së gjithash, duhet pranue, se rezultati nuk ndryshon ndonse ai mbërrihet me rrugë të kundërt. E vërteta asht, se fitimi nuk u rrit, sepse u paksue paga, por paga u paksue, sepse u rrit fitimi. Me të njajtën sasi pune të tjetrit blen një shumë ma të madhe vleftash shkëmbimi, pa e pague punën ma tepër, dmth. puna paguhet ma pak në krahasim me t'ardhunat neto, që ajo i sjell kapitalistit.

Përveç kësaj, duhet të përmendim, se, me gjithë lëkundjet e çmimeve të mallnave, çmimi mesatar i çdo malli, proporcioni, simbas të cilit ky shkëmbihet me mallnat tjera, përcaktohet nga shpenzimet e tij të prodhimit. Prandej humbjet reciproke të kapitalistëve, mbrenda kufijve të klasës së kapitalistëve në tansi, barazohen

patjetër. Perfeksionimi i maqinave, përdorimi i ri i forcave të natyrës në shërbim të prodhimit, krijojnë mundsin për të prodhues në një kohë të caktuar pune, me të njëjtën sasi pune dhe kapitali, një sasi më të madhe produktesh, por jo një sasi më të madhe vlefash shkëmbimi. Nëqoftëse tue përdorë një maqinë tjetërse unë mund të prodhoj në një orë dy herë më shumë fije tjera, se sa prodhojsa para çpikjes së saj, për shembull, 100 funt në vend të 50, si shkëmbim për këta 100 funt unë nuk do të marr, mesatarisht, për një kohë pak a shumë të gjatë, më shumë mallna, se sa merrej më parë për 50 funt, sepse shpenzimet e s prodhimit u paksuen përgjysmë ose sepse me të njëjtat shpenzime unë mund të prodhoj dy herë më shumë produkte.

Ma në fund, cilido përpjestim qoftë, në të cilin klasa kapitaliste, borgjezija, — qoftë e një vendi të vetëm ose e gjithë tregut botnor — i ndan t'ardhurat neto të prodhimit, shumën e përgjithshme e këtyne t'ardhurve neto kurdoherë asht barazi me shumën, që puna e gjallë e ka shtue në tansi punës s'akumuluar. Kjo shumë e përgjithshme, pra, rritet në të njëjtin përpjestim, në të cilin puna rrit kapitalin, dmth. n'at përpjestim, në të cilin fitimi rritet në krahasim me pagën.

Pra, ne shohim, se, edhe po të qëndrojmë mbrenda kufijve të marrëdhënjëve midis kapitalit dhe punës me mëditje, interesat e kapitalit dhe interesat e punës me mëditje janë diametralisht të kundërta.

Rritja e shpejtë e kapitalit do të thotë rritja e shpejtë e fitimit. Fitimi mund të rritet shpejt vetëm kur çmimi i punës, kur paga relative zbret po me at shpejtsi. Paga relative mund të paksohej madje edhe kur bashkë me pagën nominale, me vleftën në të holla të punës, rritet edhe paga reale, nëqoftëse kjo e fundit nuk rritet në të njëjtën shkallë, në të cilën rritet fitimi. Nëqoftëse, për shembull, në kohën, kur punët venë mirë, paga rritet 50%, ndërsa fitimi rritet 30%, atëherë paga e krahasueshme, relative, nuk shtohet, por paksohet.

Në qoftë, pra, se me rritjen e shpejtë të kapitalit shtohen edhe t'ardhunat e puntorit, njikohsisht me këte thellohet edhe hendeku shoqnor, që ndan puntorin nga kapitalisti, shtohet pushteti i kapitalit mbi punën, mvarsija e punës nga kapitali.

Të pohojsh, se puntorit i intereson që kapitali rritet shpejt, në të vërtetë do të thotë vetëm se: sa ma shpejt që puntori e shton pasunin e tjetrit, aq ma shumë thërrime të majme i mbeten atij, aq ma i madh asht numri i puntorëve, që mund të gjejnë punë dhe që mund të lindin, aq ma shumë mund të shtohet sasija e skllavëve, që mvaren nga kapitali. Pra, ne pamë se:

Edhe situata ma e favorshme për klasën puntotore, rritja sa më e shpejtë e kapitalit, sado që ajo ta përmirsojë jetën materiale të puntorit, nuk e zhduk kontrastin midis interesave të tij dhe interesave të borgjezit, interesave të kapitalistëve. Fitimi dhe paga, si edhe ma parë, janë në përpjestim të zhdrejtë me njani tjetrin.

Poqese kapitali rritet shpejt, megjithse edhe paga mund të rritet, fitimi i kapitalistit rritet shumë ma shpejt. Gjendja materiale e puntorit përmirsohet, por në kurriz të gjendjes së tij shoqnore. Hendeku shoqnor, që e ndan atë nga kapitalisti, thellohet.

Ma në fund:

Të pohojsh, se kushti ma i favorshëm për punën me mëditje asht rritja sa ma e shpejtë e kapitalit prodhues, në të vërtetë don të thotë vetëm, se: sa ma shpejt klasa puntore e shton dhe e rrit foreën anmiqsore për të, pasunin e tjetrit, sundon mbi të, aq ma të favorshme janë kushtet, në të cilat ajo mund të punojë për ta shtue përsëri pasunin borgjeze, për ta shtue pushtetin e kapitalit, tue u kënaqë, se ajo vetë farkon vargojet e florihtë, me të cilat borgjezija e tërheq atë mbas vehtes.

V

Po a asht e vërtetë, se rritja e kapitalit prodhues asht e lidhun ngushtsisht me rritjen e pagës, siç thonë ekonomistët borgjezë? Ne nuk duhet t'u besojmë fjalëve të tyre. Ne nuk mund t'i besojmë atyne edhe kur thonë, se gjoja sa ma i majmë të jetë kapitali, aq ma mirë ushqehet skllavi i tij. Borgjezija asht shumë e zgjuet, ajo i ban hesapet shumë mirë për të pasë paragjykimet e feudalit, i cili mburrej me shkëlqimin e shërbëtorëve të tij. Kushtet e egzistencës së borgjezis e shtrëngojnë at që të jetë e matun.

Prandej ne duhet ta studjojmë ma afër kët çashtje:

Si ndikon rritja e kapitalit prodhues mbi pagën? Nëqoftëse kapitali prodhues i shoqnis borgjeze në tansi rritet, atëherë bahet një akumulim ma i gjithanshëm i punës. Numri i kapitalistëve dhe kapitalet e tyne rriten. Rritja e kapitaleve e shton konkurencën midis kapitalistëve. Rritja e madhsis së kapitaleve krijon mundsin e që në sheshin e betejës industriale të dalin ushtri ma të fuqishme puntorësh, t'armatosun me armë lufte gjithnji më të mëdha.

Nji kapitalist mund ta zhduki tjetrin nga fusha e betejës dhe ta shtjeri në dorë kapitalin e tij vetëm tue shitë ma lirë. Po që të ketë mundsi të shesi ma lirë pa u rrenue, ai duhet të prodhojë ma lirë, dmth. duhet ta shtojë sa ma shum forcën prodhuese të punës. Por forca prodhuese e punës rritet, në radhë të parë, me anën e një ndamjeje më të madhe ta punës, me anën e përdorimit të gjithanshëm dhe perfeksionimit të parreshtun të maqinave. Sa ma e madhe asht ushtria e puntorëve, midis të cilëve ndahet puna, sa ma e madhe asht shkalla e përdorimit të maqinave, aq ma shpejt relativisht paksohen shpenzimet e prodhimit, aq ma e frytshme bahet puna. Prandej midis kapitalistëve lind një konkurrencë e gjithanshme — ata përpiqen të rrisin ndamjen e punës, të përdorin maqineri ma shum dhe ta shfrytzojnë ate sa të jetë e mundun në një shkallë ma të madhe.

Por nëqoftëse një kapitalist, në saje të ndamjes ma të madhe të punës, të përdorimit të maqinave të reja dhe të

perfekcionimit të tyne, në saje të shfrytzimit ma me leverdi dhe në mënyrë ma të gjanë të forcave të natyrës, ka mundsi që, me të njajtën sasi pune, ose pune t'akumulume, të prodhojë një sasi ma të madhe produktesh, mallnash, se sa konkurentët e tij, nëqoftëse, për shembull, në të njajtën kohë, gjatë së cilës konkurentët e tij endin një gjysmë kuti pëlhurë, ai mund të prodhojë një kut, atëherë si do të veprojë ky kapitalist?

Ai mund të vazhdojë me e shitë një gjysmë kuti pëlhurë me çmimin e maparshëm të tregut, por në këtë rast ai nuk do të mund t'i zhdukte kundërshtarët e tij nga fusha e betejës dhe nuk do të mund ta shtonte shitjen e tij. Nga ana tjetër, po n'at masë, në të cilën zgjanohet prodhimi i tij, po në këtë masë rritet edhe nevoja e tij për të shitë. Mjetet e prodhimit ma të fuqishme e ma të shtrejta, që ai përdor, i japin mundsi atij t'i shesi mallnat ma lirë, por njëkohsisht ato e shtrëngojnë atë që të shesi ma shumë mallna, të pushtojë për mallnat e tij një treg shumë ma të gjanë; prandaj kapitalisti ynë do ta shesi një gjysmë kuti pëlhurë ma lirë se konkurentët e tij.

Megjithse prodhimi i një kuti kapitalistit nuk i kushton ma shumë, se sa u kushton të tjerëve prodhimi i një ngjysmë kuti, ai nuk do ta shesi një kut me at çmim, me të cilin konkurentët e tij shesin në gjysmë kuti. Përndryshe ai nuk do të kishte asnjë fitim të tepërt, por vetëm do të merrte, me anën e shkëmbimit, shpenzime e tij të prodhimit. Dhe nëqoftëse t'ardhunat e tij, prapsepap, do të rriteshin, kjo do të ndodhte vetëm sepse ai përdor një kapital ma të madh, por jo sepse kapitali i tij e rrits vleftën e vet ma

shum, se kapitalet tjera. Përveç kësaj; ai do ta mbërrijë qëllimin që synon, nëqoftëse çmimin e mallit të vet e cakton vetëm disa përqind më pak se konkurentët e tij. Tue i ulë çmimet ai i zhduk konkurentët e tij nga tregu, ose, të paktën, u heq atyne mundsin për të shitë një pjesë të mallnave të tyre. Ma në fund, të mos harrojmë, se çmimi i përditshëm asht ma i madh ose ma i vogël, se shpenzimet e prodhimit, simbas rastit nëse shitja e mallit bahet, në një stinë të favorshme ose jo të favorshme për industrinë. Nëse çmimi i tregut i një kuti, pëlhere asht ma i madh ose ma i vogël se shpenzimet e zakonshme të prodhimit deri në at kohë, nga kjo do të ndryshojë edhe përqindja, që do ta marrë mbi shpenzimet e tij të vërteta të prodhimit kapitalisti, i cili ka përdorë mjete prodhimi të reja dhe që japin prodhim ma shumë.

Por privilegji i kapitalistit tonë nuk zgjat shumë kohë: kapitalistët tjerë, që konkurojnë me të, përdorin po ato maquina, po at ndamje pune, i përdorin ato po në at shkallë ose në një shkallë ma të madhe - dhe këto shpikje të reja përhapen aq shumë, sa që çmimi i pëlhurës bie jo vetëm nën shpenzimet e maparshme të prodhimit, por edhe nën shpenzimet e reja të prodhimit.

Pra, kapitalistët do të gjinden njëri kundrejt tjetrit po në at gjendje, në të cilën gjindeshin përpara përdorimit të mjeteve të reja të prodhimit; dhe nëqoftëse në saje të këtyre mjeteve të prodhimit ata mund të hedhin në treg, me çmimin e maparshëm, një sasi të dyfishtë produktesh, tash ata janë që tue shtue sasin e produkteve, që shet, të mbulojë ramjen e çmimit të shitjes: sepse shitja e një sasije

ma të madhe mallnash tash atij i duhet jo vetëm për të pasë fitim ma shumë, por edhe për të zavendsue shpenzimet e prodhimit, — vetë veglat e prodhimit, si e pamë, shtrejtohen gjithnji ma shumë; meqenëse kjo shitje e madhe asht ba tash një çashtje jete ose vdekje jo vetëm për të, por edhe për konkurentët e tij, lufta e vjetër shpërthen përsëri aq ma e ashpër, sa ma të frytshme janë mjetet e prodhimit, që janë shpikë. Pra, ndamja e punës dhe përdorimi i maqinave do të zhvillohen ma tej përsëri në një shkallë ende ma të madhe.

Cilado qoftë fuqija e mjeteve të prodhimit, që përdoren, konkurenca përpiqet t'i rrëmbejë kapitalit frytet e arta të kësaj fuqije, tue e çue çmimin e mallit deri në nivelin e shpenzimeve të prodhimit, tue ba që posa të krijohet mundësija për të prodhue ma lirë, dmth. për të prodhue ma shumë produkte me të njajtën sasi pune, ajo e bani një ligj të pashmangshëm lirsimin e prodhimit, hedhjen në treg të një sasije produktesh gjithnji ma të madhe me te njajtën shumë çmimesh. Në këtë mënyrë del, se me përpjekjet e tij kapitalisti nuk fiton gja tjetër, veçse asht i detyruem që tash gjatë së njajtës kohë pune të prodhojë mallna ma shumë, me një fjalë ai nuk fiton asgja tjetër, vecse keqsimin e kushteve, në të cilat bahet rritja e vleftës së kapitalit të tij. Ndërsa konkurenca e ndjek pa rreshtë kapitalistin me ligjin e saj të shpenzimeve të prodhimit dhe çdo armë, që ai farkon kundër rivaleve të tij, kthehet kundër atij vetë, kapitalisti përpiqet vazhdimisht që t'ia kalojë konkurrencës, tue zavendsue pa reshtue maqinerin e vjetër me maqineri të re ma të shtrejtë, por që prodhon ma lirë,

dhe ndamjen e vjetër të punës me ndamje të re pune, dhe nuk pret sa që konkurenca ta vjetrojë maqinerin e re.

Tash, le të përfytyrojmë, se kjo nxitje e ethëshme pushton njikohsisht gjithë tregun botnor, dhe do të kuptojmë se si rritja, akumulimi dhe koncentrimi i kapitalit çojnë në ndamjen e parreshtun të punës, që përmbys vetevehten dhe përdoret në një shkallë gjithnji ma të madhe, në përdorimin e maqineris së re dhe në perfeksionimin e maqineris së vjetër.

Po si këto rrethana, që janë të pandame nga rritja e kapitalit prodhues, ndikojnë mbi përcaktimin e pagës?

Nji ndamje pune ma e madhe krijon mundsinn që nji punor të bajë punën e 5, 10, 20 vetëve; ajo, pra, e shton 5, 10, 20 herë konkurencën midis punrëve. Konkurenca midis puntorëve nuk shprehet vetëm në faktin, se nji puntor e shet vehten ma lirë se tjetri, por edhe në faktin, se nji puntor ban punën e 5, 10, 20 vetëve; dhe, për të ba këtë lloj konkurrence puntorët i shtrëngon ndamja e punës, që përdoret dhe zgjanohet pa rreshtë nga kapitali.

Mandej. Sa ma shum rritet ndamja e punës, aq ma shum puna thjeshtohet. Zotsija e veçantë e puntorit humb vleftën e saj. Puntori shndërrohet në nji forcë prodhuese të thjeshtë, të njianshme, prej të cilit nuk kërkohen aftësi e zotsi të veçanta. fizike ose mendore. Puna e tij bahet nji punë, që mund ta bajë cilido. Prandej, nga të gjitha anët, puntorit i vërsulen konkurentë; dhe, përveç kësaj, të mos harrojmë se sa ma e thjeshtë të jetë puna, sa, ma lehtë që ajo mësohet, sa ma të vogla të jenë shpenzimet e

prodhimit, që duhen për ta përvehtësue aq ma poshtë bie paga, sepse ajo, si çmim i çdo malli tjetër, përcaktohet nga shpenzimet e prodhimit.

Pra, sa ma tepër puna bahet e neveritshme dhe pa kënaqsi, — aq ma tepër shtohet konkurenca dhe paksohet paga. Puntori përpiqet që ta ruejë shumën e përgjithshme të pagës së tij, tue punue ma shum: punon ma tepër orë ose prodhon ma tepër gjatë një ore. I shtymë nga nevoja, ai i ban edhe ma të randa pasojat vdekjepruese të ndamjes së punës. Rezultati asht ky: sa ma tepër punon, aq ma pak paguhet; dhe kjo ngjet për arsyen e thjeshtë se sa ma shum që ai punon, aq ma shum u ban konkurrencë shokëve të tij të punës, tue i shndërrue këta në konkurentë të vehtes së tij, të cilët pranojnë po ato kushte të këqija, që pranon edhe ai vetë; pra, për arsyen e thjeshtë, sepse, në fund të fundit, ai i ban konkurrencë vetë vehtes, vetë vehtes si antar i klasës puntore.

Maqinat shkaktojnë të njajtat pasoja, por në një shkallë shum ma të madhe, sepse ato zavendojnë puntorët e kualifikuem me puntorë të pakualifikuem, burrat me gratë, të rritunit me fëmijë, sepse maqinat, që me përdorimin e tyre të parë, hedhin në mes të rrugës sasi shum të mëdha puntorësh të thjeshtë, ndërsa me zhvillimin, përmirsimin dhe perfeksionimin e tyre të matejshëm, ato nxjerrin nga fabrikat grupe të veçanta puntorësh. Ma sipër ne përshkruem në vija të përgjithshme luftën industriale midis kapitalistëve; veçorija e kësaj lufte asht, se në të betejat nuk fitohen aq tue e rritë ushtrin vepruese, se sa tue e paksue ate. Prisat,

kapitalistët, luftojnë midis tyre se kush mund të lirojë ma shumë ushtarë t'industris.

Asht e vërtetë që ekonomistët na thonë neve, se puntorët, të cilët, gjoja për shkak të maqinave, bahen të tepërt, gjejnë punë në degë të reja t'industris.

Ata nuk guxojnë të thonë haptazi, se në degët e reja të punës gjejnë vend po ata puntorë, të cilët nxirren nga puna. Faktet flasin me za shumë të fortë kundër kësaj rrene. Ata, në të vërtetë, thonë, se kundër kësaj rrene. Ata, në të vërtetë, thonë, se ra përbase të klasës puntore, për shembull, për at pjesë të brezit të ri të puntorëve, që ishte gati të hynte në degën e industris së shkatrueme. Kjo, sigurisht, asht një ngushllim i madh për puntorët e mbetun pa punë. Zotnijve kapitalistë nuk do t'u mungojnë mish edhe gjak i freskët të përshtatshëm për shfrytzim, - dhe ata u lanë kujdesin të vdekunve që të vorrosin të vdekunit e tyre. Ky asht një ngushllim, që borgjezët i bajnë ma tepër vehtes së tyre, se sa puntorëve. Në të vërtetë, sikur maqinat të zhdukshin gjithë klasën e puntorëve me mëditje, — sa e tmershme do t'ishte kjo për kapitalin, i cili pa punë me mëditje pushon së qeni kapital!

Por, le ta zamë, se puntorët, që zavendsohen drejtpërdrejt nga maqinat, si dhe gjithë pjesa e brezit të ri, që shpresonte të gjente punë në një degë të caktueme t'industris, gjejnë punë të re. Po a mund të besohet, se puna e re do të paguhet po aq nalt, sa paguhej edhe puna e humbun? Kjo do të ishte ne kundërshtim me të gjitha ligjet ekonomike. Ne pamë se si industria e sotme ban që puna ma e

ndërlikueme dhe ma e naltë të zavendsohet me punë ma të thjeshtë, ma t'ulët.

Në kët rast, masa e puntorëve, të zavendsuem nga maqinat në një degë t 'industris, mund të gjejë strehë në një degë tjetër, veçse tue u pague ma pak e ma keq.

Si përjashtim, kanë përmendë puntorët, që punojnë në prodhimin e vet maqinave. Derisa, gjoja, n'industri nevojiten dhe përdoren ma shum maqina, sasiya e tyne duhet të rritet në mënyrë të pashmangshme pra, duhet të rritet edhe prodhimi i maqinave dhe krahas me këte edhe numri i puntorëve, që punojnë për prodhimin e tyne; ndërsa dihet, se puntorët, që punojnë në kët degë t'industris, janë puntorë të kualifikuem dhe për ma tepër - puntorë me arsim.

Tue fillue nga vjeti 1840 ky pohim, i cili edhe ma parë ka qenë i vërtetë vetëm përgjysmë, humbi çdo vleftë, sepse për prodhimin e maqinave përdoren gjithnji ma shum maqinat, ashtu sikurse përdoren edhe për prodhimin e fijeve të pambukta; dhe puntorët, që punojnë në prodhimin e maqinave, në krahasim me maqinat shum të perfeksionueme, mund të luejnë vetëm rolin e maqinave fare të paperfeksionueme.

Por në vend të një burri, që maqina nxjerr jashtë, fabrika mund të marri në punë, ndoshta, tre fëmij dhe një grue! Dhe paga e burrit vallë a nuk duhej të mjaftonte për t'ushqye tre fëmij dhe një grue? Paga minimale vallë a nuk duhej të mjaftonte për të ruejtë dhe shtue gjinin? Po ç'vërtetojnë këto fraza, që i pëlqejnë borgjezis? Ato

vërtetojnë vetëm një gjë: se tash për të siguruar ekzistencën e një familjeje puntore harxhohen katër herë më shumë jeta puntorësh, se më parë.

T'i përmbledhim ato, që thamë: Sa më shumë rritet kapitali prodhues, aq më shumë zgjanohet ndamja e punës dhe përdorimi i makinave. Sa më shumë zgjanohet ndamja e punës dhe përdorimi i makinave, aq më shumë shtohet konkurrenca midis puntorëve, aq më shumë paksohet paga e tyre.

Për më tepër, rradhët e klasës puntore shtohen edhe nga shtresat më të ulëta të shoqërisë; në rradhët e klasës puntore kalon një pjesë e kapitalistëve dhe rentjerëve të vegjël, të cilëve nuk u mbetet gjë tjetër, veçse të ngrejë sa më parë krahët e tyre pranë krahëve të puntorëve. Kështu pylli i krahëve të ngritur përpjetë, që kërkojnë punë, bahet gjithnjë më i dendur, ndërsa vet krahët thahen gjithnjë më shumë.

Kuptohet vetëvetiu, se kapitalisti i vogël nuk mund t'i bëjë ballë luftës, në të cilën një nga kushtet e para të saj është që prodhimi të rritet në përpjestime gjithnjë më të mëdha, dmth domosdoshmëria për të qenë kapitalist i madh dhe jo kapitalist i vogël.

Sigurisht, nuk ka nevojë të shpjegohet më shumë edhe çashtja, se përqindja e kapitalit paksohet në atë shkallë, në të cilën rritet kapitali, shtohet sasija dhe numri i kapitaleve; prandaj rentjeri i vogël nuk mund të jetojë me rentën e tij, dhe duhet të hidhet në industri, dmth. të shtojë rradhët e

kapitalistëve të vegjël dhe njikohsisht ta rriti numrin e kandidatëve për proletarë.

Ma në fund, sa ma shumë zhvillimi i përshkruem ma sipër i shtrëngon kapitalistët të shfrytzojnë në përpjestime gjithnjë ma të mëdha mjetet ekzistuese të prodhimit, dhe për këtë qëllim të vejnë në lëvizje të gjitha levat e kredis, aq ma të shpeshta bahen tërmetet industriale, kur bota tregtare mbahet vetëm tue u sakrifikue përëndive të nëntokës një pjesë të pasunis, të produkteve dhe madje të forcave prodhuese, — me një fjalë, aq ma shumë shtohen krizat. Ato bahen ma të shpeshta dhe ma të forta, sepse sa ma shumë rritet sasija e produkteve, pra, si rrjedhim, rritet edhe nevoja për zgjanimin e tregjeve, aq ma shumë ngushtohet tregu botnor, aq ma pak tregje të reja mbeten për t'u shfrytzuë, sepse çdo krizë e maparshme ka tërheqë në tregtin botnore tregje reja ose që deri n'at kohë shfrytzoreshin prej saj vetëm përciptazi. Por kapitali nuk jeton vetëm në kurriz të punës; ai, si skllavopronar barbar dhe fisnik merr me vehte në vorr kufomat e skllavëve të tij haktakombe të tana puntorësh, që vdesin në kohën e krizave. Ne shohim, pra, se; nëqoftëse kapitali rritet shpejt, konkurenca midis puntorëve rritet ende ma shpejt, dmth sa ma shpejt të rritet kapitali, aq ma shumë relativisht paksohen burimet për të gjetë punë, mjetet e jetesës për klasën puntore, dhe, megjithatë, rritja e shpejtë e kapitalit asht kushti ma i favorshëm për punën me mëditje.